



TLAS

Raport Vjetor 2008

Falenderojmë CAFOD UK
për mbështetjen financiare të këtij botimi

CAFOD
just one world

SHERBIMI LIGJOR FALAS TIRANE (TLAS)

RAPORTI VJETOR 2008

Tiranë 2008



Të dashur përfitues, donatorë dhe partnerë të TLAS,

Më lejoni të shpreh kënaqësinë për të paraqitur dokumentin më të rëndësishëm të TLAS: Raportin Vjetor 2008.

Ashtu si dhe në vitet e mëparshme, plani i ofrimit të shërbimeve të TLAS bazohet në prioritetet strategjike të parashikuara për të përmirësuar aftësinë e organizatës për të përmbushur nevojat ligjore të individëve

me të ardhura të pamjaftueshme në Tiranë dhe në qytete të tjera.

Së pari, ofrimi i shërbimeve nga TLAS vazhdon të përqëndrohet në informacionin dhe këshillimin ligjor si dhe në përfaqësimet në gjykatë e përpara organeve administrative; Së dyti, TLAS vazhdon t'i kushtojë vëmendje të posaçme ndërgjegjësimit ligjor të komunitetit përmes aktiviteteve "street law", shërbimeve të lëvizshme, seminareve e trainimeve si dhe bashkëpunimit me partnerët tanë në sistemin e drejtësisë, në administratën shtetërore dhe OJF-t; Së treti, TLAS vazhdon në mënyrë të pandërprerë të ndërmarrë nisma për përmirësime ligjore dhe fushata avokatie e lobimi; Së fundi, të gjitha këto kanë diktuar riorganizimin e vazhdueshëm të TLAS për të përballuar ngarkesën e përditshme dhe përmirësuar administrimin e shërbimeve ndaj përfituesve e klientëve.

Siç mund të shihet në këtë raport, TLAS nuk është vetëm një ofrues efikas shërbimesh, por po jep ndihmesën e tij për ngritjen e kapaciteteve të organizatave komunitare, të cilat përfaqësojnë grupet e synuara të TLAS, drejtuesve të komunitetit si dhe punonjësve të administratave lokale. Një nga projektet më të rëndësishme të TLAS në vitin 2008 ishte nisma ligjore për përfundimin e hartimit të Ligjit për "Ndihmën Juridike" në Shqipëri, si dhe fushata e avokatisë dhe lobimit për miratimin e tij. Kjo nismë u kurorëzua me sukses me miratimin e ligjit nga Kuvendi i Shqipërisë në 22 Dhjetor 2008 dhe dekretimin e tij nga Presidenti më 12 Janar 2009.

TLAS dhe bashkëpunorët e tij në këtë fushë ndihen krenarë para përfituesve sepse ligji synon pikërisht rritjen e aksesit në sistemin e ndihmës juridike dhe në drejtësi, synon financimin nga Shteti të këtij shërbimi, gjë që sigurisht do të forcojë kapacitetet e ofruesve të shërbimeve ligjore falas në të gjithë vendin.

Së fundi, Raporti Vjetor 2008 është një vështrim i përgjithshëm, i saktë dhe informues mbi punën dhe performancën e TLAS për realizimin e objektivave, mbi metodologjinë e përdorur nga staf, studentët, vullnetarët dhe partnerët, arritjet kryesore të shërbimit bazuar në të dhëna statistikore dhe histori të vërteta të përfituesve. Shpresojmë që informacioni i ofruar të jetë i dobishëm për lexuesit e interesuar,

Me respekt,

Raimonda BOZO
Drejtoresh e TLAS

RAPORTI VJETOR 2008 I SHERBIMIT LIGJOR FALAS TIRANE (TLAS)

Ky Raport Vjetor pasqyron aktivitetin e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë gjatë vitit 2008 dhe përpiqet të japë një vështrim të përgjithshëm, të saktë dhe informues mbi punën dhe performancën për realizimin e objektivave, metodologjinë e përdorur nga stafi, studentët, vullnetarët dhe partnerët, arritjet kryesore të shërbimit, të dhëna statistikore dhe histori të vërteta/raste studimore. Shpresojmë që informacioni i ofruar të jetë i dobishëm dhe i kuptueshëm për lexuesit e interesuar.

Raporti Vjetor i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë, mbulon periudhën Janar 2008 – Dhjetor 2008 dhe është në përputhje me kërkesat dhe kushtet e Raportit Vjetor të Auditimit & Administrimit Financiar.

PJESA I - INFORMACION PER SHERBIMIN LIGJOR FALAS TIRANE (TLAS)

Viti 2008 shënon vitin e dhjetë të aktivitetit të TLAS dhe një tjetër vit të suksesshëm të dekadës së parë. Me ndihmën dhe mbështetjen e donatorëve, partnerëve, stafit dhe përfituesve të klientëve të tij, TLAS vazhdon të bëjë hapa cilësorë në ofrimin e shërbimeve, në zgjerimin e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe në ndërmarrjen e nismave për përmirësimin e legjislacionit. Në kuadrin e riorganizimit të pandërprerë për t'ju përgjigjur nevojave dhe kërkesave të grupeve të synuara, për të përballuar vështirësitë dhe sfidat, TLAS i përqëndroi përpjekjet në zbatimin e një strategjie sa më eficiente për ngritjen e fondeve, në mënyrë që të sigurohej vazhdimësia e aktivitetit të organizatës, të respektohej misioni dhe sigurohej cilësia e shërbimeve të ofruara për kategoritë më vulnerabël në Tiranë dhe rrethe të tjera të vendit tonë.

Sot, TLAS njihet në të gjithë Shqipërinë si një nga organizatat më serioze në ofrimin e shërbimeve ligjore falas për njerëzit në nevojë, në fushën e ndërgjegjësimit dhe përmirësimit të legjislacionit.

Vlerat e TLAS: Sjellja e ndryshimeve të reja nëpërmjet besimit, respektit, shërbimit dhe punës me të tjerët.

Vizioni i TLAS: Një sistem ligjor falas i ri dhe bashkëpunues që i përgjigjet nevojave të personave me të ardhura të pamjaftueshme.

Misioni: Përmbushja e nevojave sociale dhe ligjore të njerëzve në nevojë; edukimi dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë shqiptare për shtetin ligjor dhe të drejtat e njeriut; nxitja e përmirësimeve në legjislacionin shqiptar; përparimi i komunitetit dhe forcimi i demokracisë në Shqipëri.

Objektivat: Ofrimi i shërbimeve ligjore për njerëzit në nevojë; Publikimi i informacioneve të rëndësishme ligjore dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë shqiptare për shtetin ligjor dhe të drejtat e njeriut; Avokati dhe lobim për përmirësimin e legjislacionit për zgjidhje më të mirë të problemeve.

Metodologjia e TLAS për të ofruar me cilësi dhe përkushtim një seri shërbimesh që përfshijnë informimin, edukimin, këshillimin dhe përfaqësimin ligjor të personave në nevojë përbëhet nga:

a. Shërbimet

- *Paraligjore* (zgjidhjen e çështjeve ligjore në rrugë administrative);
- *Ligjore* (zgjidhjen e çështjeve nëpërmjet procedurave gjyqësore);
- *Lawline* (këshillim ligjor nëpërmjet telefonit);
- *Clinics* (përgatitja ligjore e klientëve për vetëpërfaqësim para organeve shtetërore dhe gjykatës);
- *Ndërmjetësimi* (zgjidhje alternative e mosmarrëveshjeve);
- *Shërbimet “Mobile”* (shërbime ligjore të ofruara ndaj klientëve në zona të largëta me mundësi të kufizuara).

b. Aktivitete të “Street Law”: Publikim, informim, edukim dhe ndërgjegjësim ligjor i komunitetit

TLAS organizon vizita dhe takime përmes aktiviteteve të “Street Law” në zonat urbane dhe rurale të Tiranës dhe qyteteve të tjera, publikon botime të ndryshme ligjore për këto aktivitete të shkruara në një gjuhë të thjeshtë për përdorim publik. Gjithashtu, TLAS boton çdo katër muaj revistën e tij, e cila pasqyron nevojat ligjore të komunitetit dhe shërben si burim informacioni dhe edukimi për grupet e synuara.

c) Monitorimi i aktiviteteve në sistemin ligjor

TLAS ka përgatitur disa raporte monitoruese: Raportin mbi nivelin e korrupsionit në Sistemin e Noterisë; Raportin mbi aktivitetin e Zyrave të Përmbarimit në Shqipëri; Raportin mbi funksionimin dhe punën e Administratës Gjyqësore; Raportin mbi monitorimin e nivelit të kënqësisë së publikut ndaj shërbimeve të ofruara nga Gjykatat, etj.

d) Aktivitete të fushës së avokatisë dhe lobimit

TLAS i kushton vëmendje të veçantë aktiviteteve të avokatisë dhe lobimit për ndërmarrjen e nismave ligjore, si për përmirësimin e legjislacionit ekzistues, ashtu edhe për hartimin e ligjeve të reja, të diktuar dhe identifikuar nga problemet që hasin grupet në nevojë.

TLAS është përfshirë në nismën ligjore për ndryshimin e ligjit Nr. 7698, datë 15. 04. 1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, ndryshime të cilat u miratuan në Korrik 2004;

TLAS draftoi amendimin e ligjit Nr 8950 “Për gjendjen civile”, ndryshime te cilat u miratuan në Korrik 2008; TLAS hartoi ligjin “Për Ndihmën Juridike”, ligj i cili u miratua në Dhjetor 2008.

Gjithashtu, TLAS ka përgatitur ndryshimet e kuadrit ligjor për veprimtarinë e stafit të administratës gjyqësore, u përfshi në përgatitjen e akteve nënligjore për profesionin e avokatit në Shqipëri, mbështeti kategorinë e ushtarakëve të aksidentuar gjatë detyrës për hartimin e akteve ligjore për përfitimin e paaftësisë, mbështeti dhe hartoi aktet nënligjore të ish të dënuarve për krime jopolitike gjatë periudhës 1945-1990 në mënyrë që t’ju njihen vitet e punës gjatë denimit në llogaritjen e pensionit të pleqërisë, etj.

e) Programi “Internship” i studentëve

Grupe studentësh nga Fakultetet e Drejtësisë dhe të Punës Sociale janë vazhdimisht të pranishëm në TLAS, të përfshirë në aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuere të “Street law”, në shërbimet ligjore “Mobile”, në asistimin e menaxhimin e rasteve të klientëve si dhe në projekte të tjera të monitorimit, vëzhgimit, nismave ligjore, trajnimeve, etj.

f) Ngritja e kapaciteteve ligjore të OJF-ve, përfaqësuese të grupeve të synuara të TLAS përmes: Regjistrimit në gjykatë të shoqatave lokale dhe seminareve të trainimit për forcimin e kapaciteteve të tyre ligjore.

g) Aktivitete trainimi për nëpunësit e strukturave shtetërore

- Seminare trainimi për nëpunësit e administratës publike
- Seminare trainimi për gjyqtarët dhe administratën e gjykatave
- Seminare trainimi për nëpunësit e zyrave të gjendjes civile

Fusha e Ligjit

TLAS ofron shërbime ligjore për çështjet civile, administrative, familjare dhe të punës si dhe për rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut.

TLAS ka përfutur nga financimet e donatorëve dhe e ka zgjeruar programin e tij duke trajtuar sistematikisht problemet e njerëzve në nevojë si dhe ka vazhduar ofrimin e shërbimit të tij për klientët e vecantë. TLAS ka ndihmuar klientët me të ardhura të pamjaftueshme që jetojnë në Rrethin e Tiranës, duke përfaqësuar si ata që jetojnë në zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Edhe pse TLAS e ka selinë e tij në qytetin e Tiranës, shërbimet ligjore të ofruara nga TLAS, si *lawline*, shërbimet e lëvizshme, trainimet apo aktivitetet e “*Street Law*” (edukimi ligjor i komunitetit) i kanë kaluar kufijtë e Tiranës duke ar-

ritur zona të tilla si Lushnja, Fushë Kruja, Durrësi, Fieri, Berati, Elbasani, Kukesi, Bulqiza, Peshkopia, Tropoja, Hasi, etj.

Duke marrë parasysh vështirësitë me të cilat është përballur TLAS, në sistemin gjyqësor dhe administratën publike, mund të thuhet se cilësia e shërbimit të tij ka qenë e kënaqshme dhe konkretisht gjatë vitit 2008, 92% e rasteve të trajtuara në rrugë gjyqësore kanë qenë të suksesshme dhe 86 % e rasteve të trajtuara në rrugë administrative kanë qenë të suksesshme. Ndërmjet grupeve më të mëdha të përfituesve të TLAS kanë qenë pjesëtarët e pakicave, personat me paafësi fizike ose mendore, pensionistët, të papunët si dhe familjet e tjera me atë ardhura të pamjaftueshme. Gjatë vitit 2008, më tepër se 52,5 % e rasteve kanë të bëjnë me regjistrimin e lindjeve 22.3% me sistemin e përfitimeve shoqërore, 7,5% me mosmarrëveshje pronësi, rreth 15% me gjendjen civile, rreth 2% mosmarrëveshje pune, etj.

TLAS vepron në përputhje me planin strategjik afatmesëm 2007 - 2010, që parashikon në të ardhmen përsosjen cilësore të metodologjisë për arritjen e tre objektivave themelore, atë të shërbimeve, të informimit dhe përmirësimit të legjislacionit. Prioritet i TLAS mbeten problemet sistematike që prekin grupe të njerëzve në nevojë më shumë sesa rastet individuale të klientëve të vecantë, por sigurisht pa lënë pas dore edhe këto të fundit. Projektet kryesore të TLAS gjatë vitit 2008 kanë synuar rastet e regjistrimit të lindjeve të fëmijëve dhe të të rriturve, rastet për përfitim nga sigurimet shoqërore e shtetërore, raste të mosmarrëveshjeve të pronësisë, çështje të së drejtës familjare, nismat për draftimin e ligjeve të reja, programet e monitorimit, trainimi i punonjësve të administratës gjyqësore, asaj publike dhe OJF-ve.

PJESA II – RAPORTI VJETOR 2008

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) e ka filluar veprimtarinë e tij në Janar të vitit 1999. Aktiviteti i TLAS gjatë vitit 2008 bazohet në projektin “Shërbimi Ligjor Falas për shtresat në nevojë” dhe është bërë i mundur në sajë të financimeve të:

- * CAFOD UK, Fondi Katolik për Zhvillimin Vendeve të Përtej Detit, Britania e Madhe
- * UNICEF, Programi për mbrojtjen e Fëmijeve i Kombeve të Bashkuara
- * SHC, Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
- * SOROS, Fondacioni i Shoqërisë së hapur për Shqipërinë
- * UNDP, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
- * USAID/ ROLP, Agjensia Ndërkombëtare për Zhvillim, SHBA/
Programi i Zbatimit të Ligjit
- * Ambasada Amerikane, Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci
- * Terre des Homes Tiranë,
- * Partnerët për Fëmijët Tiranë
- * Benchmark Institute, San Francisco



Swedish Helsinki Committee

for Human Rights



A. GJENDJA AKTUALE

Shqipëria, edhe më shumë se vendet e tjera të Europës Qendrore dhe Lindore po vazhdon të përballet me një sërë vështirësish për shkak të procesit të tranzicionit.

Kujdesi ndaj Komunitetit Rom

Megjithëse Qeveria Shqiptare po zbaton me sukses reformat politike, sociale dhe ekonomike, pas shumë viteve stabiliteti relativ dhe rritjeje ekonomike, vendi mund të konsiderohet si një nga më të varfërit në Europë. Bie në sy varfëria e disa pakicave kombëtare të veçanta si rezultat i përjashtimit dhe diskriminimit. Statistikat paraqesin të dhëna alarmante veçanërisht për pakicën Rome në Shqipëri. Një studim mbi Vulnerabilitetin e Komunitetit Rom tregon se 55% e anëtarëve të këtij minoriteti që kanë mbushur moshën 15 vjeç apo më të rinj janë analfabetë, krahasuar kjo me 2% të popullsisë jo Rome. Një pjesë e madhe e familjeve Rome jetojnë në zona informale, pa infrastrukturë, pa instalime elektrike dhe uji dhe pa kanalizime të ujrave të zeza. Për komunitetin Rom varfëria është e shumëllojshme, ekstreme dhe kronike.

Ekzistojnë faktorë të ndryshëm që ndikojnë në izolimin e komunitetit Rom ku ndër të tjera dallon mungesa e strehimit, e arsimit dhe niveli i lartë i papunësisë. Por në mënyrë të ndjeshme në përjashtimin e komunitetit Rom ndikon mungesa e dokumenteve ligjorë si ato të identifikimit pa të cilat nuk mund të aksesojnë as të klasifikohen për programet sociale të ndihmës ekonomike, të institucioneve të edukimit, të shërbimeve shëndetësore, të punësimit apo trainimit profesional, etj. Pakicat vulnerabël hasin vështirësi në procesin e regjistrimit në përgjithësi, e konsiderojnë atë të ndërlikuar dhe të kush-tueshëm, edhe pse e kuptojnë se regjistrimi civil i lejon akses më të madh në shërbimet që shteti ofron.

Shteti shqiptar ka pranuar nevojën e integritetit të komunitetit Rom në shoqëri. Janë krijuar disa organizma shtetërorë për mbrojtjen dhe nxitjen e pakicave kombëtare si Komiteti Ndërministerial i Pakicave Kombëtare në Këshillin e Ministriva (nën mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të Kryeministrit), Komiteti i Pakicave në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Komiteti Monitorues i Romëve (sot quhet Sekretariati Teknik i Romëve) në Ministrinë e Punës, Ceshtjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta. Është hartuar dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave në vitin 2003 **“Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e**

Kushteve të Jetesës së Komunitetit Rom” si dhe është nënshkruar në verën e vitit 2008, deklarata e “Dekadës së Përfshirjes së Komunitetit Rom” (2005-2015)¹.

Në këto kushte, aktiviteti i TLAS i ka kushtuar vemendje te veçantë mbështetjes ligjore dhe sociale të Komunitetit Rom. Përveç shërbimeve të drejtpërdrejta ligjore (ku vendin kryesor e kanë zënë regjistrimet civile)², TLAS ka ofruar për pjesëtarët e këtij komuniteti, trajnime specifike me synim forcimin e kapaciteteve të organizatave të komunitetit rom; trainime me punonjësit e administratës gjyqësore për rritjen e aksesit në gjykatë të pjesëtarëve të këtij komuniteti; trainime me organizatat komunitare rome për të drejtat sociale dhe ligjore që ata gëzojnë dhe për mënyrën sesi mund të përfitohet nga këto të drejta. Gjithashtu, një numër i madh aktivitetesh Street Law janë zhvilluar në zonat informale të banuara kryesisht nga ky komunitet.

Grupimet e tjera të popullsisë së migruar, jo rome

Popullsia në Shqipëri po zhvendoset me ritme të shpejta nga zonat rurale në ato urbane. Migracioni i brendshëm i shpejtë po krijon probleme me mjedisin dhe probleme të tjera në përdorimin e shërbimeve publike. Qyteti i Tiranës po përballlet me një presion gjithnjë e në rritje nga të ardhurit nga zonat veriore të Shqipërisë. Dobësia e strukturave shtetërore dhe kuadri i varfër ligjor për ligjshmërinë e zhvendosjes së kësaj popullsie po krijon mjaft probleme për regjistrimin e popullsisë, dhe ndikime të tjera negative për arsimimin, punësimin, si dhe zbatimin e sistemit të përfitimeve sociale, politikat e strehimit, etj.

1 Dekada e Përfshirjes Rome 2005–2015 është një angazhim politik i pa hasur më parë i qeverive të Europës Qendrore dhe Juglindore, për të përmirësuar gjendjen ekonomiko-sociale dhe përfshirjen e Romëve në kuadrin rajonal. Dekada është një nismë ndërkombëtare që bashkon Qeveritë, organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare, si dhe shoqërinë civile Rome për të përshpejtuar progresin në përmirësimin e gjendjes ekonomike të Romëve dhe për ta riparë këtë progress në një mënyrë transparente dhe sasiore. Dekada përqëndrohet në fushat prioritare të arsimit, punësimit, shëndetësisë dhe strehimit dhe angazhon qeveritë për të trajtuar çështjet e tjera kryesore të shkaqeve të varfërisë, diskriminimit dhe përqasjes gjinore. Në këtë nismë janë përfshirë 11 vende: Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Sllovakia, si dhe Shqipëria dhe Bosnje-Herecegovina si anëtarët më të rinj që i janë bashkuar Dekadës në verën e vitit 2008. Të gjitha këto vende kanë një numër të madh të pakicave Rome dhe ku pakicat Rome janë të disavantazuara, si ekonomikisht ashtu edhe nga ana sociale. Secili prej këtyre vendeve ka hartuar një Plan Veprimi Kombëtar për Dekadën që përcakton synimet dhe treguesit në këto fusha prioritare. Spanja është një vend që është ftuar t’i bashkohet nismës së Dekadës dhe ka deklaruar qëllimin e saj për t’u bërë një anëtar i saj. Sllovenia, si vend i trembëdhjetë ka statusin e vëzhguesit. Për më shumë informacion, ju lutem vizitoni faqen e internetit: <http://www.romadecade.org/>. Sekretariati Teknik Rom është ish Njësia e Monitorimit Rome e cila deri në Dhjetor 2008 ka vepruar nën Shërbimin Social Shtetëror, një institucion nën varësinë e MoLSAEO. Kohët e fundit Njësia është bërë pjesë e Drejtorisë për Strategjitë e Përbashkëta të MoLSAEO dhe është emërtuar zyrtarisht si Sekretariati Teknik Rom.

2 Me regjistrime civile kuptohen regjistrimet që kryhen pranë zyrave të gjendjes civile, si për shembull regjistrimet e lindjeve, regjistrimet e vdekjeve, martesat, transferimi i të dhënave të gjendjes civile, etj.

Sistemi i ndihmës ligjore falas në Shqipëri u institucionalizua.

Gjatë viteve 2007- 2008, TLAS filloi zbatimin e njërës prej projekteve më ambicioze, atë të hartimit dhe miratimit të Ligjit për “Ndihmën Juridike”³. TLAS angazhoi ekspertët më të mirë në Shqipëri në fushën e të drejtës civile, të drejtës administrative, të drejtës penale, menaxhimit dhe administrimit për hartimin e projekt-ligjit për “Ndihmën Juridike” në Shqipëri. Pas diskutimeve të shumta, komenteve dhe fushatave ndërgjegjëse e lobuese të organizuara nga TLAS në disa rrethe të vendit, projekt-ligji u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë si Ligji nr.10039, datë 22.12.2008. Ligji u dekretua nga Presidenti i Shqipërisë në datën 12.01.2009 dhe hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare. Tashmë Shqipëria përmes këtij ligji institucionalizoi sistemin e ofrimit të ndihmës juridike por shumë akte të tjera duhet të hartohen e miratohen në mënyrë që ky kuadër të plotësohet.

TLAS në vazhdimësi, bazuar në ekspertizën 10 vjecare, do të angazhohet për fazën përgatitore të zbatimit të Ligjit, bazuar në një Strategji të veçantë për të garantuar: (i) buxhetin dhe burimet e nevojshme që do t'i jepen ofruesve të shërbimeve ligjore falas të cilët do të asistojnë individët dhe grupet në nevojë (ii) respektimin e detyrimeve ndërkombëtare nga shteti për sigurimin e aksesit në drejtësi për të gjithë, (iii) forcimin e sistemit gjyqësor përmes sistemit të ndihmës ligjore për mbrojtjen e të drejtave themelore, (iv) përmirësimin e sistemit demokratik të qeverisjes dhe shoqërisë.

B. AKTIVITETET E PROJEKTIT

TLAS, bazuar në Planit Operacional 2008, synoi të arrijë objektivat e mëposhtëm:

I.1 Ofrimin e shërbimeve ligjore falas për çështjet civile për 1500 individë në nevojë (Romë, pakica të tjera, invalidë, jetimë, penisionistë dhe individë të varfër pa të ardhura të mjaftueshme) në Tiranë, Lushnjë, Fushe Kruje, Durrës, Elbasan, Kukes, Bulqizë, Peshkopi, Tropojë, Has, Fier, etj.

I.2 Informimi dhe ndërgjegjësimi i më shumë se 4500 individëve në nevojë nga Tirana dhe rrethet e tjera të Shqipërisë për të drejtat ligjore dhe sociale

³ Kur themi “Ndihmë juridike” nënkuptojmë të drejtën që kanë individët me të ardhura të pamjaftueshme për të përfituar shërbime ligjore falas (që përfshijnë informimin, këshillimin, hartimin e dokumentave ligjore dhe përfaqësimin në administratë e gjykatë), për çështje civile dhe penale. Ligjin për Ndihmën Juridike, pas botimit në Fletoren Zyrtare, mund ta gjeni në faqen e internetit: www.tlas.org.al.

dhe për të drejtën e aksesit në drejtësi.

I.3 Ndërmarrja e nismave për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

AKTIVITETET NE LIDHJE ME OBJEKTIVIN E PARE

Ofrimin e shërbimeve ligjore falas të drejtpërdrejta për çështjet civile për 1660 individë në nevojë (Romë, pakica të tjera, invalidë, jetimë, pensionistë dhe individë të varfër pa mbështetje) në Tiranë, Lushnjë, Fushë-Krujë, Durës, Elbasan, Kukës, Bulqizë, Peshkopi, Tropoje, Has, Fier, etc.

i) Rritja e numrit të klientëve të TLAS.

Në fund të Dhjetorit 2008, numri i përgjithshëm i klientëve të TLAS që kishin përfituar shërbim paraligjor, ligjor dhe kliniks arriti shifrën 10236 nga të cilat 5945 janë raste paraligjore dhe 4291 janë raste ligjore.

Vetëm gjatë vitit 2008, u shërbyen 1660 raste klientësh (956 raste paraligjore dhe 704 raste ligjore), duke përfshirë edhe 99 rastet e transferuara nga viti 2007⁴. Gjatë vitit 2008 përfituan nga shërbimi i këshillimit ligjor nëpërmjet telefonit (shërbimi lawline) rreth 467 individë. Ky numër nuk përfshin numrin e këshillimeve që kanë përfituar këta personave nga paraqitja e tyre personalisht në zyrë, pasi ato janë llogaritur si shërbime të përfaqësimit ligjor.

744 raste ose pothuajse 44% e klientëve të rinj i përkasin komunitetit Rom në Tiranë, Elbasan dhe Fier, dhe shumica e tyre kanë përfituar regjistrimin e lindjes së fëmijëve, zgjidhje martesash, regjistrime të vdekjeve e raste të tjera.

Edhe gjatë vitit 2008 prioritet ishte rritja e cilësisë së shërbimit dhe zhvillimit të aktiviteteve informuese për publikimin e TLAS tek grupet potenciale të klientëve përmes:

- Shpërndarjes së posterave dhe fletëpalosjeve si dhe botimeve të reja të revistës së TLAS, kryesisht nëpërmjet aktiviteteve të street law (për më tepër shiko Aktivitetet e Street law në këtë raport).

- Botimeve dhe shpërndarjes së revistave nr.1/2008, 2/2008, 3/2008 të TLAS.

- Takimeve me përfaqësuesit e shoqatave që kanë si anëtare grupet e synuara të TLAS, takime këto të cilat, krahas trajtimit të temave të ndryshme ligjore dhe sociale mund të konsiderohen si aktivitete për publikimin e TLAS (Lute-

⁴ Për të dhëna statistikore më të hollësishme dhe krahasuese, bazuar në të dhënat e regjistruara në Bazën e të Dhënave të TLAS, (shihni shtojcën 1, bashkëlidhur këtij Raporti).

mi, shihni pjesën përkatëse në këtë raport);

- Shpërndarjes së botimeve të TLAS si Manuali për Kodin e Procedurave Administrative, fletëpalosje të vecanta për të drejtën e informimit, për ligjin për Gjendjen Civile, për Ligjin për Ndhimën Juridike, për Aksesin në Drejtësi, për Shërbimet Ligjore Falas në Gërdec, udhëzuesin ligjor “Si dhe kush përfiton nga shërbimet sociale”; variantin e udhëzuesit në kasetë audio, i regjistruar posaçërisht për pakicat analfabete; studimin për “Nevojat ligjore të Komunitetit Rom”; studimin për “Opinionin e Klientëve të TLAS për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve të ndihmës ligjore”, etj.

- Fushata ndërgjegjësuere në Media përmes intervistave dhe spoteve televizive ka patur ndër të tjera synim promovimin e mëtejshëm të shërbimeve ligjore të TLAS në shkallë vendi dhe ndërgjegjësimin e kategorive në nevojë për të kërkuar të drejtat që u takojnë. Janë realizuar 5 emisione të drejtpërdrejta televizive në News 24 dhe Vizion + , transmetimi i dy spoteve të rëndësishme televizive në TVSH, TOP Chanel, 24 News dhe 18 televizione lokale, përkatësisht për njohjen e publikut me ndryshimet në ligjin e gjendjes civile si dhe për rritjen e shkallës së sensibilizimit për miratimin e ligjit të Ndimës Juridike.

Gazeta TLAS Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë Nr.2 2007

- Në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë vazhdon të qëndrojë e vendosur një tabelë informuese, ku jepet në mënyrë të përgjithshme informacion mbi shërbimet e TLAS dhe kriteret e përzgjedhjes.

- Gjatë vitit 2008, TLAS vazhdoi të ofronte shërbime ligjore falas në kushte “Mobile”, duke u përqëndruar në zonat më problematike kryesisht të komunitetit Rom, si një mënyrë efikase për të rritur aksesin e këtij komuniteti në drejtësi.

- TLAS edhe gjatë 2008 kryesoi me shumë sukses koalicionin e BKTF (Së bashku Kundër Trafikimit të Fëmijëve), koalicion prej 21 organizatash jo fitimprurëse që punonjnë kryesisht në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga shfrytëzimi, abuzimi e trafikimi. Në prezantimin e Raportit të Analizës, organizuar për këtë qëllim në Hotel Rogner mori pjesë edhe Kryeministri i Shqipërisë, Presidenti i UNICEF, Ambasadori i SHBA në Tiranë, e partnerë të tjerë të rëndësishëm. Pjesëmarrja në këtë Koalicion ka ngritur në një shkallë më lartë punën në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve vulnerabël, si një nga target grupet kryesore të TLAS.

- Është e rëndësishme të përmendet se një numër i madh i klientëve të rinj rekomandohen nga partnerët e TLAS në institucionet shtetërore lokale e qendrore si: Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit, Drejtoria e Përgjith-

shme e Gjendjes Civile, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Bashkia e Tiranës, Njësitë Administrative në Tiranë dhe Komunitat, Gjykatat, por dhe nga partnerët e rëndësishëm të shoqërisë civile si Qendra për Iniciativa Ligjore dhe Qytetare, Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra Shqiptare për Praktika të Integruara ose Klinika për të Miturit, Shoqatat dhe organizatat Rome si dhe organizata të tjera komunitare.

ii) Cilësia e Shërbimit

Sic u përmënd edhe më lart, cilësia e shërbimeve të ofruara ka qënë prioriteti i TLAS edhe në 2008. Cilësia është parë si domosdoshmëri për të përmbushur nevojat dhe shpresat e klientëve dhe si kriter për plotësimin e objektivave e standarteve të miratuara për këtë qëllim. Për rritjen e cilësisë së shërbimit janë ndërmarrë këto hapa:

- Regjistrimi i TLAS si person juridik, u shoqërua me ndryshimin e organeve drejtuese të Qendrës të miratuara në aktin e themelimit. Bordi Drejtues i TLAS ka treguar vëmendje të vecantë për përcaktimin e politikave strategjike për zhvillimin e mëtejshëm organizativ të TLAS. Miratimi i Planit Strategjik të 2007-2010, i Strategjisë Financiare dhe Ngritjes së Fondeve 2007-2010, i Planit Operacional të 2008, i Rregullores së Brendshme të TLAS si dhe i politikave të tjera të zhvillimit organizativ, kanë ndikuar pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe koordinimit të aktiviteteve në përgjithësi. Bordi Drejtues është mbledhur 3 herë për të diskutuar dhe marrë vendime gjatë 2008.

- Dihet që TLAS ofron këshillime e shërbime ligjore për çështjet civile dhe organizimin i punës sipas specialitetit të avokatit, bazuar në llojin, objektin dhe shkallën e vështirësisë (mosmarrëveshjet familjare, regjistrimi i lindjeve, pronësia e truallit, mosmarrëveshjet e punës, sigurimet, etj) ka ndihmuar ndjeshëm në rritjen e cilësisë së shërbimeve.

- Duke qënë se TLAS ka anëtar të stafit një nga avokatët më të mire në çështjet civile, detyrë e tij ka qënë kualifikimi dhe mbikqyrja e rregullt e punës së avokatëve më të rinj.

- Mbledhjet e rregullta të stafit kanë ndihmuar në përmirësimin e procedurave që kanë të bëjnë me punën me klientët dhe me koordinimin e punës në grup të stafit të TLAS, që do të thotë se këshilltari, avokati, financieri dhe studentët e programit internship ndajnë detyrat specifike në mënyrë që çështja të kompletohet në kohën e duhur.

- Vazhdimi i zbatimit të Politikave Nr. 1 “Përzgjedhja e rasteve të bazuara

ligjërisht” dhe Nr. 2 “Përdorimi i Ndërmjetësimit nga TLAS” ka rritur shkallën e suksesit në trajtimin e çështjeve të klientëve.

-Dokumenti i Politikave për zbatimin e Procedurave të Ankimit, filluar që në Mars 2002 i jep të drejtë klientëve të ankohen përpara Drejtorit Ekzekutiv të TLAS për cilësinë e shërbimit që i ofrohet.

- Gjithashtu, përdorimi i pyetësorëve për të marrë mendimin e klientëve për trajtimin e çështjeve të tyre është informacion i rëndësishëm për përmirësimin e punës së stafit të TLAS.

- Janë bërë përpjekje në vazhdimësi për të **përmirësuar praktikat dhe politikat e ofrimit të shërbimeve ndaj shtresave më të varfëra** (përmirësimi i formularit të deklaratimit, vlerësimi i aseteve, përveç të ardhurave personale, etj). Nga ana tjetër, këto përpjekje kanë synuar ofrimin e shërbimit pa cënuar parimin e konkurrencës së drejtë ndërmjet avokatëve.

- Trainimi i vazhdueshëm i stafit të TLAS konsiderohet në mënyrë të pandërprerë si shumë i rëndësishëm për rritjen e cilësisë së shërbimit (për më shumë hollësi shihni pjesën e menaxhimit dhe administrimit në këtë raport).

- Puna e avokatit të shërbimit ligjor telefonik (Lawline) dhe i rasteve “Clinics”, i cili ka më tepër se 20 vjet përvojë në sistemin gjyqësor në Shqipëri i ka treguar rezultatet e tij edhe në rritjen e reputacionit të shërbimit të TLAS.

- Përdorimi i Bazës së të Dhënave “Clients 2000” është gjithashtu mjet i rëndësishëm dhe fillesa ku bazohet cilësia e shërbimit, jo vetëm për saktësinë e regjistrimit të të dhënave të klientëve, të llojit të rasteve por konsiderohet në të njëjtën kohë dhe faza e parë e vlerësimit të nevojave ligjore të komunitetit. Baza e të Dhënave ka shërbyer dhe shërben si mjeti themelor i vëzhgimeve dhe studimeve të organizuara nga TLAS. Puna e TLAS është e dokumentuar mjaft mirë për të gjithë aktivitetin e dekadës së parë, pasi që në vitin 2000 TLAS instaloi programin profesional kompjuterik “Kemp’s Case Works”, i cili përdoret nga shumë Shoqëri të Ndihmës ligjore në të gjithë botën.

- Aktiviteti i TLAS është shqyrtuar dhe vlerësuar rregullisht nga konsulentë të jashtëm të pavarur, kryesisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Mbretëria e Bashkuar. Janë bërë gjashtë Raporte Vlerësimi në një periudhë 10 vjeçare duke filluar nga eksperti Tony Trott, i Ndihmës Ligjore në Mbretërinë e Bashkuar; Richard Langan i Universitetit të Columbia, SHBA; Bruce Perrone dhe Barbara Bays nga Ndihma Ligjore e Virxhinias Perëndimore, SHBA; Rosemary French dhe Marie Contreras nga Instituti Benchmark i San Francisco, SHBA; përfaqësues të Bashkimit Europian në kuadrin e Projektit CARDS, nga Daniel Manning, Grater Legal aid Boston, etj. Rekomandimet e konsulentëve janë përqëndruar kryesisht në menaxhimin e rasteve, qëndrueshmërinë e projektit dhe zhvillimin strategjik. Aktualisht, aktiviteti i TLAS ba-

zohet në Planin Strategjik 2007-2010 dhe është përqëndruar në: 1) Shërbimet ndaj klientëve; 2) fushatat e ndërgjegjësimit të komunitetit për akses më të mirë në të drejtat ligjore; 3) fushata avokatie dhe lobimi për përmirësime ligjore dhe politika sociale; 4) trainime të stafit dhe ngritjen e fondeve.

- Raportet Vjetore të TLAS, perfshirë dhe auditimin e pavaruar finciar, publikohen çdo vit në formë të shtypur dhe atë elektronike dhe i shpërndahen përfituesve dhe aktorëve kryesorë të fushës.

- Përmirësime cilësore janë arritur dhe përmes bashkëpunimit dhe referimit të çështjeve tek institucionet dhe zyrat partnere të ndihmës ligjore si në Zyrën e Avokatit të Popullit, në Klinikën Ligjore për të Miturit, Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave të Paafte, në Qendrat për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, në Qendrën për Iniciativa Ligjore dhe Qytetare (ish-Qendrën Avokatore për Gratë), në Komitetin e Helsinkit, etj, të cilët kanë në fokus të veprimtarisë së tyre mbështetjen e grupeve të varfëra. Bashkëpunimi me shërbimet e mësipërme konsiston jo vetëm në referimin reciprok të klientëve, por edhe në zbatimin e projekteve të përbashkëta. TLAS ka zbatuar projekte të përbashkëta me Qendrën Për Iniciativa Ligjore dhe Qytetare (ish-Qendra Avokatore për Gratë), Terre Des Home, Partners for Children, Qendrën për Zgjidhjen e Konfliktëve e Mosmarrëveshjeve, me organizatat Rome, Unionin Amaro-Drom, koalicionin e BKTF, etj.

- Nga ana tjetër TLAS ka bërë hapa shumë pozitive për të forcuar marrëdhëniet me organet shtetërore, veçanërisht Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Bashkinë e Tiranës. TLAS ka nënshkruar në Korrik 2008 një Memorandum Bashkëpunimi me Ministrinë e Brendshme, për të organizuar një fushatë gjithëpërfshirëse ndërgjegjësimi për ndryshimet në Ligjin “Për Gjendjen Civile” me anë të medias, botimeve, spoteve dhe konferencave si dhe për fillimin e trajnimeve me punonjësit e zyrave të gjendjes civile, fushata këto që e kanë rritur ndjeshëm prezencën e TLAS në shkallë vendi. Si rezultat i këtij bashkëpunimi për herë të parë në dhjetë vjetë aktivitet, TLAS me mbështetjen e Ministrisë së Brendshme dhe të UNICEF, mbledhi në Hotel Tirana më tepër se 300 punonjës të gjendjeve civile nga të gjitha zonat rurale dhe urbane të Shqipërisë dhe në vijim filloi projektimin e seminareve të trajnimeve në katër qytetet e para, Tiranë, Elbasan, Fier dhe Durrës.

- Tryezat e rumbullakta për prezantimin e Projekt ligjit të Ndihmës Juridike në Tiranë ku mori pjesë Ministri i Drejtësisë, Z. Enkelejd Alibeaj, Zëvendës Kryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë Z. Kreshnik Spahiu, Avokati i popullit z. Ermir Dobjani, dhe partnerë të tjerë të rëndësishëm të TLAS; vazhdimi i tyre në Korçë, Shkodër dhe Vlorë, shfaqja e spotit televiziv për këtë që-

llim, shpërndarja e materialeve të tjera informuese për projekt ligjin kurorëzuan me sukses miratimin e tij nga Parlament në Dhjetor 2008. Kjo fushatë ndërgjegjësimi promovoi më tej veprimtarinë dhe ndihmesën e TLAS në shkallë vendi për fuqizimin e shërbimeve ligjore ndaj shtresave vulnerabël përmes ndërtimit të një sistemi të plotë të Ndihmës Juridike.

iii) Trainimi i stafit të TLAS:

1. Avokatja më e re TLAS vazhdoi traditën e nisur nga anëtarët e tjerë të TLAS për t'u trajnuar në "College of Advocacy", organizuar në Tetor 2008 nga Instituti Benchmark, San Francisco, SHBA.
2. Avokatja tjetër e TLAS u trainua në Strasbourg, Francë me temë "Trainimi i juristëve shqiptarë rreth Konventës Europane për të Drejtat e Njeriut", në 25-28 Shkurt, 2008.
3. Avokatët e TLAS u trainuan për Hartimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore dhe planit të saj të veprimit 2008 – 2010, mbajtur në 13 Mars, 3 Prill dhe 10 Prill, 2008.
4. Këshilltarja e TLAS ka prezantuar kontributin e organizatës për minoritetin Rom në konferencën e "10 vjetorit të Konventës Kuadër për të Drejtat e Minoriteteve Kombëtare", Strasburg, Francë, Tetor 2008. TLAS është një nga anëtarët aktiv dhe një nga nënshkruesit e Deklaratës së NGO've të hartuar me rastin e 10 vjetorit të Konventës.
5. Drejtori Ekzekutiv dhe punonjësja e Administratë/ Financës morën pjesë në trainimin me temë "Udhëzues për Drejtuesit e OJF-ve për Financat", organizuar nga Fabel, Werner & Schnittke GmbH më 15-16 Dhjetor, 2008.
6. Dy nga avokatët e TLAS vazhdojnë kualifikimet përkatësisht në Fakultetin Ekonomik të UT për "Administrim Publik" dhe në Shkollën Shqiptare të Studimeve Politike.
7. Dy avokatët më me përvojë të TLAS janë pedagogë të jashtëm në Fakultetet e Drejtësisë UFO dhe në Shkollën e Magjistraturës, përkatësisht në lëndët: E drejta Administrative dhe Procedura Civile.

iv) Marrëdhëniet e TLAS me partnerët:

- Që nga Shkurti 2001, TLAS është anëtar aktiv i Koalicionit Shqiptar të OJF-ve kundër Korrupsionit dhe që nga Dhjetori 2006 është anëtar aktiv dhe njëkohësisht kryesoi Koalicionin e BKTF's gjatë viteve 2007 dhe 2008.
- Shoqatat që kanë si anëtarë të tyre, klientë potencialë të TLAS të cilët plotësojnë kriteret e përzgjedhshmërisë kanë qenë në qendër të vëmendjes dhe me to janë zhvilluar këto aktivitete:



Tiranë, Shkurt 2008. U organizua tryeza e rumbullakët me pjesëmarrjen e anëtarëve të shoqatës Kombëtare për Mbrojtjen e Punës dhe të Demokracisë në Shqipëri, në lidhje me strategjinë për ndërmarrjen e hapave të mëtejshëshëm për njohjen e viteve të punës së të ish-të dënuarve jo-politikë në Shqipëri, gjatë viteve 1945-1990.



Durrës, Shkurt 2008. U organizua seminari me nëpunës të zyrave të gjendjes civile Durrës, si dhe anëtarë të shoqatës Alba-Rom, Shoqata Durrësi, Shoqata e Grave me Probleme sociale, në lidhje me rritjen e aksesit të publikut në drejtësi përmes përmirësimit të shërbimit, rritjes së transparencës dhe etikës profesionale.



Tiranë, Mars 2008. U organizua seminari me anëtarët e shoqatës “Zemra e Nënës”, për forcimin institucional të organizatave që kanë si anëtarë të tyre grupet e synuara të TLAS.



Tiranë, Korrik 2008. Seminar trajnues me anëtarët e shoqatës “Alba Rom”, me temë “Ndërgjegjësimi i Komunitetit Rom për njohjen dhe kuptimin e disa ndryshimeve të ligjit të gjendjes civile dhe roli i shoqatave në përmirësimin e këtij shërbimi nga strukturat lokale”.



Tiranë, Shtator 2008. Seminar trainimi i organizuar me përfaqësuesit e shoqatave Rome në Tiranë, Durës, Elbasan, Fier, me temë forcimi i kapaciteteve të organizatave rome dhe ndihma ligjore për regjistrimet civile.



Tiranë, Tetor 2008. Konferencë e Koalicionit BKTF e kryesuar nga TLAS, me pjesëmarrjen e Kryeministrit Z. Sali Berisha dhe Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Z. John L. Withers II.



Tiranë, Nëntor 2008. Seminar trainues me anëtarët e Qendrës për një Vizion Bashkëkohor Rom për "Ndërgjegjësimin e Komunitetit Rom për ndryshimet e ligjit 'Për Gjendjen Civile' si dhe programet sociale që ofron shteti".

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) ka zhvilluar seminare dhe trainime të ndryshme në kuadrin e ndërgjegjësimit të organeve shtetërore për nevojat e grupeve të synuara të TLAS:



Tiranë, Qershor 2008. Tryezë e rrumbullakët me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Komitetit Shqiptar të Helsinki, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, etj me temë “Përmirësimi i Sistemit të Ndihmës Ligjor kusht për rritjen e aksesit në drejtësi.



Tiranë, Korrik 2008. Tryezë e rrumbullakët me punonjës të zyrave të gjendjes civile nga i gjithë vendi (340 pjesëmarrës), për rritjen e shkallës së perceptimit të ndryshimeve në ligjin e gjendjes civile për regjistrimin e lindjeve.



Elbasan, Shtator 2008. Seminar trainues me punonjësit e administratës gjyqësore, avokatët dhe gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Elbasan, për “Ndihmën ligjore dhe aksesit në gjykatë i komuniteteve vulnerabël (komuniteti rom dhe egjiptian)”.



Fier, Shtator 2008. Seminar train-ues me punonjësit e administratës gjyqësore, avokatët dhe gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Elbasan, për “Ndihmen ligjore dhe aksesin në gjykatë të komuniteteve të vulnerabël (komuniteti rom dhe egjiptian)”.



Vlorë, Tetor 2008. Tryezë e rrumbullakët me përfaqësues të pushtetit lokal, avokatë, gjyqtarë, etj për “Përsosjen e Sistemit për Ofrimin e Ndihmës Juridike në Shqipëri”.



Shkodër, Tetor 2008. Tryezë e rrumbullakët me përfaqësues të pushtetit lokal, avokatë, gjyqtarë, etj për “Përsosjen e Sistemit për Ofrimin e Ndihmës Juridike në Shqipëri”.



Korçë, Nëntor 2008. Tryezë e rrumbullakët me përfaqësues të pushtetit lokal, avokatë, gjyqtarë, etj për “Përsosjen e Sistemit për Ofrimin e Ndihmës Juridike në Shqipëri”.

Gjatë seminareve dhe takimeve me organizatat e grupeve të synuara u identifikuan dhe u asistuan me ndihmë ligjore tre nisma për regjistrime të OJF-ve të reja. Janë ndihmuar për themelimin dhe janë regjistruar në Gjykatë, Shoqata e Romëve të Veriut, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 05. 12. 2008; Shoqata e Romëve të Bashkuar në Berat, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 09. 06. 2008; Shoqata “Hope for Roma Vision” e cila është ende në procedurat e regjistrimit në gjykatë.

AKTIVITETET NE LIDHJE ME OBJEKTIVIN E DYTE

OBJEKTIVI I.2 Informimi dhe ndërgjegjësimi i më shumë se 4800 individëve në nevojë nga Tirana dhe rrethet e tjera të Shqipërisë për të drejtat ligjore dhe sociale dhe për të drejtën e aksesit në drejtësi.

i) Aktivitetet e “Street law”

Në vijim të shërbimeve ligjore në zyrë, TLAS ka organizuar aktivitete të “Street Law” për shpërndarjen e botimeve, për publikimin e informacioneve të thjeshta ligjore e komunikimin direkt me përfituesit. Objekti kryesor i aktiviteteve të Street Law ka qenë “Informimi mbi të drejtat civile”. Numri i studentëve vullnetarë nga Fakultetet e Drejtësisë dhe Punës Sociale, pjesë e programit të intership në TLAS ka ardhur duke u rritur. Ata punojnë me pasion si në fazën parapërgatitore të grumbullimit të fletëpalosjeve dhe broshurave, edhe në identifikimin e temave që duhet t’i interesojnë komunitetit.



Gjatë vitit 2008, grupet e *street law* të TLAS kanë realizuar 48 aktivitete si vizita dhe takime të planifikuara, në Rrethin e Tiranës, në Fushë-Krujë, në Durrës, në Fier, Shkodër dhe Elbasan.

Disa nga temat e zgjedhura për aktivitetet e *street law* përfshinin:

- Ligjin e Gjendjes Civile dhe ndryshimet e tij;
- Legjislacioni i përkrahjes sociale;
- Çfarë është akses në drejtësi dhe të drejtat ligjore themelore të individit;
- Të drejtat e grupeve vulnerabël për strehim, arsim dhe kujdesin shëndetësor;
- Njohuri të përgjithshme mbi Ligjin “Për Ndihmën Juridike”, etj.



Vizitat në komunitet: Këto takime janë informale dhe kanë si objekt bisedat e stafit të TLAS me persona të komunitetit, takimin me persona në rrugë dhe në vende ku mbledhen njerëzit, shpërndarjen e informacionit si fletëpalosje dhe broshura, etj., si dhe identifikimin e problemet e individëve të cilët kanë nevojë për ndihmë ligjore.

Takime në Komunitet: këto takime janë më formale dhe synojnë organizimin e takimeve ku ftohen zyrtarë të pushtetit vendor dhe përfitues të shërbimeve të TLAS. Në vijim të ofritit të shërbimeve ligjore për çështjet, takimet ndihmojnë TLAS për të vlerësuar problemet e vecanta të komunitetit dhe nevojat e tyre si dhe marrin mendimin e komunitetit për aktivitetet e zhvilluara të *street law*. Shpesh prioritetet e shërbimeve të TLAS bazohen në probleme të identifikuara gjatë takimeve të *street law*. Për shembull, trajtimi i “përzgjedhjes” së klientëve të TLAS për regjistrim (si vendbanimi, vdekjet dhe lindjet) ose nismat për lobim për ndryshime në akte ligjore, përfshirjen në skemat e përfitimeve sociale, raste të strehimit, pensionit, sigurimeve, invaliditetit, etj. Këto takime ndikojnë ndjeshëm për përsosjen e metodologjisë së punës të stafit të TLAS si në përdorimin më efikas të shërbimit në përgjithësi, ai *lawline* dhe të lëvizshëm në veçanti. Gjatë aktiviteteve të *street law* automjeti i TLAS pajiset si “shërbim ligjor mobile” me të gjitha mjetet e nevojshme (laptop, printer, etj) për t’i dhënë mundësi përfituesve të marrin direkt në terren ndihmën e parë ligjore nga stafi.

ii) Revista periodike e TLAS dhe publikime të tjera:

Stafi i TLAS shtypi dhe botoi 3 numra të revistës së tij (**nr. 1/2008, 2/2008 dhe 3/2008**) të financuara nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara, UNICEF dhe CAFOD UK. Revista e TLAS është thjesht një libër për edukimin ligjor të komunitetit të shkruar në një gjuhë të thjeshtë ligjore për tema të ndjeshme ligjore për klientët e TLAS.



Numri 1, 2008 përmban projekt-ligjin “Për Ndi-hmën Juridike”; të drejtën për informim të indi-vidëve; rëndësinë e regjistrimit të fëmijëve në gjendjen civile; kujdestaria e posaçme mbi fëmi-jët; vërtetimi i faktit të viteve të punës për efekt pensioni, etj.



Numri 2, 2008 përmban artikuj mbi ndërhyrjen e TLAS në ndihmë të viktimave të tragjedisë së Gër-decit; raporti i monitorimit mbi nivelin e kënaqësisë së publikut për shërbimet e ofruara nga gjykatat; dokumentacioni dhe procedurat për përfitimin e statusit të të pastrehit; padia civile në procesin pe-nal; detyrimi ushqimor për fëmijët e lindur jashtë martese; si dhe disa histori të vërteta.



Numri 3, 2008 përmban artikuj mbi 10 vjetorin e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare; aktin administrativ dhe vecoritë e tij; Programet e qeverisë Shqiptare në luftën kundër varfërisë; të dhënat e gjendjes civile dhe kur mund të ndryshohen ato; përvoja e trainimit në Institutin Benchmark, San Francisco, Kaliforni si dhe histori të vërteta.



Janë botuar 11800 fletëpalosje dhe 3600 postera, ku pjesë të konsiderueshme zënë ato të ndryshimeve të Ligjit të Gjëndjes Civile, të aksesit në drejtësi, të shërbimeve ligjore në Gërdec, të ligjit për Ndhimën Juridike, etj. Shpërndarja e tyre është realizuar gjatë aktiviteteve të Street Law, seminareve me grupet e synuara, në tryezat e rrumbullakta, në të gjitha zyrat e gjëndjes civile në shkallë vendi, në strukturat lokale dhe qendrat shëndetësore, etj.

iii) Fushata ndërgjegjëse në Radio dhe Televizion:



Me qëllim ndërgjegjësimin e përfituesve nga ndryshimi i ligjit të gjëndjes civile gjatë muajit Korrik, Gusht 2008 u shfaq spoti televiziv i TLAS, i Financuar nga UNICEF, ne kanalet e Top Chanel, RTSH, 24 News dhe në 18 stacione lokale Televizive në të gjithë vendin.

Me qëllim intensifikimin e fushatës së avokatisë dhe lobimit për miratimin e ligjit të Ndhimës Juridike, gjatë muajit Shtator 2008, u shfaq spoti televiziv i TLAS, i financuar nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci, në kanalet televizive të Top Chanel dhe Radio Televizionit Shqiptar.



Dhjetor 2008. Avokati i TLAS mori pjesë në një emision në Televizionin “News 24” të organizuar në lidhje me administrimin e Gjykatave.

iv) Shërbimet “Mobile”:



Shërbimi ligjor “mobile” gjatë 2008 ka qënë pjesë përbërëse e Street law, ku avokati dhe këshilltari i TLAS, të cilët udhëtojnë me të gjitha pajisjet e nevojshme teknike (laptop, printer, kancelari) përgatit dokumentacionin e nevojshëm për raste të transferimit të vendbanimeve, regjistrimit të lindjeve, apo raste të tjera të identifikuar në takim. Ofrimi i shërbimit direkt në terren përmes këshillimit

apo përgatitjes së dokumentave të klientëve synon përsheptimin e procedurave, shmangien e vonesave dhe shpenzimeve të tepërta të përfituesve.



TLAS ka përlllogaritur si përfitues të aktiviteteve të ndërgjegjësimit ligjor të komunitetit (street law, fushata avokatie e lobimi, trajnime dhe seminare me grupet e synuara) më tepër se 10000 individë.

v) Programi i Internship-it



Gjatë 2008 në Programin e Internshipit në zyrat e TLAS janë përfshirë 12 studentë të Fakultetit të Drejtësisë dhe të Punës Sociale.

Programi është mbështetur nga donatorët e TLAS dhe konkretisht nga UNICEF, Komiteti Suedez i Helsinkit, Terre des Hommes, SOROS dhe UNDP. Programi nga viti në vit ka pësuar përmirësime në metodologjinë e përfshirjes efektive të studentëve në projekte të vecanta, në zyrë dhe në komunitet. Suksesi i këtij Programi pasqyrohet jo vetëm në 48 aktivitetet e Street Law të organizuara gjatë vitit 2008 por edhe në faktin që ata konsiderohen si asistentë të përditshëm të punës së avokatëve dhe këshilltarëve TLAS. Mbi bazën e një kalendari pune të ndërtuar nga vetë studentët, ata janë pjesë e në procesit të intervistimit të klientëve, pjesë e shërbimeve të tjera të ofruara nga TLAS si depozitimi i kërkesave në gjykatë, përgatitja e akteve ligjore të thjeshta, shoqërimi i klientëve tek noteri, si dhe në punë të tjera administrative të zyrës.



12 Studentë nga Fakultetet e Drejtësisë dhe Punës Sociale janë përfshirë plotësisht në zbatimin e aktiviteteve të edukimit ligjor të komunitetit “Street law” dhe shërbimet “mobile” në komunitet.

AKTIVITETET NE LIDHJE ME OBJEKTIVIN E TRETE

OBJEKTIVI I.3 Ndërmarrja e nismave për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Që në fillimet e veprimtarisë së tij, TLAS u angazhua në përmirësimin e legjislacionit shqiptar dhe në aktivitetet e lobimit dhe avokatisë, në mbrojtje të interesave të shtresave më vulnerabël.

Më poshtë po rendisim disa nga nismat më të rëndësishme ligjore të ndërmarra nga TLAS gjatë vitit 2008 si edhe gjatë viteve të mëparshme:


1. TLAS u përfshi në nismën ligjore lidhur me ndryshimin e ligjit Nr. 7698, datë 15. 04. 1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, ndryshime të cilat u pasqyruan në ligjin e miratuar në Korrik 2004.
2. TLAS hartoi ndryshime ligjore të ligjit Nr 8950 “Për gjendjen civile”, ndryshime të cilat u miratuan në Korrik 2008.

3. TLAS hartoi ligjin shqiptar “Për Ndihmën Juridike”, ligj i cili u miratua në 22 Dhjetor 2008.
4. TLAS përgatiti ndryshimet e kuadrit ligjor për veprimtarinë e stafit të administratës gjyqësore, duke hartuar në vitin 2004 disa ndryshime të akteve nënligjore.
5. TLAS u përfshi në përgatitjen e akteve nënligjore për profesionin e avokatit në Shqipëri, për përfshirjen e avokatëve të ndihmës ligjore në avokatët e kategorive të larta.
6. TLAS mbështeti kategoritë e ushtarakëve të paaftë fizikisht për hartimin e akteve ligjore për përfitimet e tyre nga paaftësia.
7. TLAS mbështeti për hartimin e akteve nënligjore individët e dënuar për krime jo-politike në periudhën 1945-1990, në mënyrë që t’u njihet periudha e punës së kryer gjatë vuajtjes së dënimit për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë.

C. NUMRI, LLOJI I RASTEVE DHE GRUPET E SYNUARA


i) Statistika:

NUMRI TOTAL I CESHTJEVE NE VITE
Janar 1999 - Dhjetor 2008




Statistikat përfaqësojnë rastet e TLAS, të cilave iu është ofruar shërbim ligjor dhe paraligjor falas. Grupet e synuara kanë përfituar nga shërbimet e TLAS si më poshtë:

NUMRI I ÇESHTJEVE SIPAS GRUPEVE TE SYNUARA
1 Janar 2008 - 31 Dhjetor 2008



NUMRI I ÇESHTJEVE SIPAS LLOJIT
1 Janar 2008 - 31 Dhjetor 2008



ii) Përfituesit:

Gjatë periudhës Januar – Dhejtor 2008 nga shërbimi i TLAS përfituan si më poshtë:

- 1660 përfitues të drejtpërdrejtë, përfshirë 99 raste të transferuara nga viti 2007
- 467 përfitues nga linja lawline
- 4800 përfitues direkt nga aktivitetet e Street Law në komunitet
- 700 përfitues direkt nga seminarët e trainimit me anëtarë të shoqatave komunitare, stafin e gjykatës në Elbasan dhe Fier, punonjës të zyrave të gjendjes civile, me strukturat lokale dhe gjykatat në, Tiranë, Vlore, Korce dhe Shkoder.
- 12.000 përfitues indirekt nga aktivitetet e TLAS gjatë 2008.

D. HISTORI TE VERTETA



Rasti i klientes SH.T:

Klientja SH.T është transferuar në Tiranë nga një zonë e thellë e Dibrës. Ajo është martuar me D.H me të cilin ka lidhur martesë, që kur ajo banonte në Dibër. Me vendosjen e tyre në një zonë të Tiranës, ata sajuan një banesë me kushte shumë të këqija higjieno-sanitare, ku jetonin bashkë me kafshë të fshatit. Ndërkohë që çifti jetonte në Tiranë ata nuk kishin realizuar transferimin e të dhënave të gjendjes civile nga Dibra në zonën e re, ku ata

banojnë aktualisht. Gjatë jetesës në këtë zonë ata lindën edhe 3 fëmijët e tyre, nërkohë që në Dibër ata kishin patur dy fëmijë të tjerë.

Klientja u paraqit pranë TLAS pasi ajo kishte të paregjistruar të katër fëmijët e saj. Gjatë intervistës me të u zbulua që familja jetonte në kushte të vështira ekonomike dhe higjieno-sanitare dhe që klientja ishte përsëri shtatzanë me fëmijën e pestë. Dy prej fëmijëve të saj ishin të lindur në Dibër pranë Qendrës Shëndetësore, por klientja kishte humbur certifikatat e lindjes të institucionit shëndetësor, ku ata ishin lindur. Për shkak të pamundësisë për të tërhequr këto certifikata TLAS bëri të mundur vajtjen e saj në Dibër duke vënë në dispozicion makinën për ta çuar klienten deri në qendrën shëndetësore të lindjes së fëmijëve të saj. Në të njëjtën kohë klientja u ndihmua që të tërhiqte certifikatat nga gjendja civile për të bërë transferimin e të dhënave të familjes prej regjistrit të gjendjes civile të mëparshme në të rene.

Pas kthimit në Tiranë familja u ndihmua që të realizonte transferimin në zyrat e gjendjes civile të rrethit të Tiranës, në mënyrë që të tërhiqeshin çertifikatat për të nisur sa më shpejt procedurat e regjistrimit të fëmijëve në regjistrat e gjendjes civile.

Duke qenë se familja u interesua për regjistrimin e fëmijëve përpara muajit korrik, procedura e vetme ishte deklarimi i lindjes së fëmijëve nëpërmjet një vendimi të gjykatës. Kështu që TLAS u angazhua në marrjen përsipër të procedurës gjyqësore të konfirmimit të faktit të lindjes së fëmijëve dhe pas marrjes së vendimit prej gjykatës, shoqërimin e klientes në zyrat e gjendjes civile dhe pagimin e gjobës.

Gjatë këtyre fazave, klientja lindi fëmijën e pestë, për të cilën ajo u këshillua që ta lindte në institucionin shëndetësor të zonës dhe të kryente deklarimin e fëmijës përpara punonjësit të gjendjes civile brenda 60 ditëve, pasi lindja e fëmijës përkonte me ndryshimet e fundit të bëra në ligjin “Për gjendjen civile” dhe sipas të cilit fëmijët e lindur përfitojnë një shumë prej 5.000 lekësh.

Kjo shumë modeste mund ta ndihmonte sadopak klienten të hiqte disa shpenzime minimale për familjen e saj.

Problemi më i madh doli për regjistrimin e dy fëmijëve të tjerë, të cilët kishin lindur në Tiranë, por jashtë kushteve të institucioneve shëndetësore. Klientja ishte ndihmuar nga të afërmit e saj për lindjen e fëmijëve në banesën me kushte të këqija, ku familja jetonte.

Gjykata është i vetmi organ, që mund të realizojë vërtetimin e faktit të lindjes së fëmijëve, dhe për këtë arsye TLAS iu drejtua asaj me një kërkesë. Megjithatë realizimi i këtyre proceseve gjyqësore nuk ishte aspak i lehtë. Avokatja ka vizituar shtëpinë e klientes duke kontaktuar disa herë me familjarët dhe komshinjtë e klientes, për të marrë informacion për lindjet dhe për t’i shpjeguar atyre sesi ata mund të ndihmonin dhe të dëshmonin në gjyq.

Më pas u kontaktua kryeplaku i fshatit dhe punonjësja e gjendjes civile, të cilët lëshuan vërtetime, që ata ishin në dijeni të familjes, ku banonte ajo dhe të fëmijëve të paregjistruar të klientes. Gjithashtu ata u bindën dhe pranuan të dëshmonin në gjykatë. Pas gjithë këtyre kontakteve mbetej që fëmijët të vizitoheshin prej mjekut të zonës, i cili duhej të lëshonte një vërtetim për gjendjen e tyre shëndetësore dhe për faktin se ata, që prej lindjes ishin vizituar dhe vaksinuar në këtë qendër shëndetësore. Mjeku dhe infermierja e qendrës pasi kryen kontrollin mjekësor dhe kontrolluan regjistrat e vizitave mjekësore lëshuan vërtetimin, ku ata theksonin se fëmijët ishin trajtuar në qendrën shëndetësore që në ditët e para të jetës së tyre. Madje dy infermiere të qendrës pranuan që edhe ato të ishin si dëshmitare në procesin gjyqësor.

Procesi gjyqësor zgjati disa muaj pasi sigurimi i vërtetimeve dhe dëshmitarëve kërkoi kohë dhe u realizua pas kontakteve të shumta.

Pas disa muajsh seancash gjyqësore, gjykata pranoi kërkesën dhe konfirmoi faktin e lindjes së dy fëmijëve të klientes Sh.T. Në fund të 5 fëmijët e saj figurojnë të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile.

Klientja filloi më pas procedurën për t'u përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, në mënyrë që të gjente një përkrahje financiare për të lehtësuar gjendjen e saj tepër të vështirë ekonomike.

Rasti i klientes M.Z

TLAS është përpjekur që ndihmën dhe kontributin e tij në ndihmë të personave në nevojë ta shtrijë edhe në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jo vetëm në kryeqytet, pasi njerëzit në nevojë hasen me vështirësi kudo në Shqipëri.

Gjatë realizimit të aktiviteteve street law në komunën Mbrostar, në qytetin e Fierit së bashku me studentët, kontaktua me shumë anëtarë të komunitetit rom, që banon në këtë zonë. Ata kishin mjaft probleme ligjore përveç atyre ekonomike, si regjistrime të fëmijëve në regjistrat e gjendjes civile, transferime, zgjidhje martesë etj.

Duke marrë dijeni për vajtjen e stafit të TLAS në këtë komunë, pranë nesh u paraqit A.P, i cili fillimisht u interesua për regjistrimin e lindjes së mbesës së tij. Djali i A.P është i moshës 19 vjeç dhe është i martuar, pa lidhur martesën ligjore me M.Z, e cila është 16 vjeçe dhe me të cilën ka një fëmijë vajzë, disa muajshe. Prindërit duke qenë në moshë të mitur në momentin e lindjes së fëmijës, nuk kishin bërë deklarinimin e lindjes së fëmijës në regjistrat e gjendjes civile pasi mendonin se mosha e tyre do t'i pengonte në këtë procedurë. Avokatja e TLAS u shpjegoi se deklarimi i fëmijës bëhet pavarësisht moshës së prindërve dhe punonjësi i gjendjes civile ka detyrimin të regjistrojë fëmijën. Problemi që u evidentua ishte se klientja M.Z kishte lindur fëmijën në qytetin e Tiranës dhe nuk kishte mjete dhe mundësi të mjaftueshme të udhëtonte në Tiranë e të tërhiqte çertifikatën e maternitetit të fëmijës. TLAS mundësoi transportin e saj në qytetin e Tiranës në maternitet, me mjetet e tij. Klientja M.Z dhe bashkëshorti i saj u këshilluan që të bënin deklarinimin e fëmijës në një nga zyrat e gjendjes civile të prindërve të fëmijës, duke u shoqëruar me dokumenta identifikues me fotografi. Prindërit e fëmijës u shoqëruan në zyrën e gjendjes civile të bashkëshortit të M.Z, pasi ata ranë dakord për këtë më parë. Regjistrimi i fëmijës u krye, por prindërit kërkuan të lidhnin martesën ligjore ndonëse nëna nuk kishte mbushur moshën ligjore për të lidhur martesë sipas Kodit të Familjes.

Po sipas nenit 7 të këtij Kodi, prindërve nën moshë u jepet një mundësi të lidhin martesën ligjore përpara arritjes së moshës 18 vjeç. Kjo realizohet duke iu drejtuar gjykatës dhe në rastin e ekzistencës së një shkakut me

rëndësi. Gjykata në përgjithësi ka konsideruar në praktikën e saj si “shkak me rëndësi” shtatzaninë apo lindjen e fëmijës. Lindja e fëmijës është një shkak i rëndësishëm, i cili u pranua prej gjykatës për të lejuar lidhjen e martesës mes prindërve pavarësisht faktit se prindërit nuk kanë arritur moshën madhore. Gjithashtu gjatë gjykimit u paraqitën si dëshmitarë edhe të afërmit e klientes dhe bashkëshortit të saj, të cilët dëshmuuan për faktin se ata bashkëjetojnë prej kohësh.

Pas dhënies së vendimit të gjykatës për lejimin e martesës ligjore u realizua martesa mes tyre në regjistrat e gjendjes civile.



Rasti i Klientes L.M:

L.M. trajtohej shumë keq nga bashkëshorti i saj, i cili përveçse është vazhdimisht në gjendje të dehur, ushtron edhe dhunë mbi të. Ai nuk jep asnjë kontribut ekonomik për të mbajtur familjen dhe L.M. është e detyruar, që gjatë gjithë ditës të grumbullojë kanoçe nëpër vendet e grumbullimit të plehrave dhe me të ardhurat që nxjerr nga shitja e tyre, të sigurojë një minimum jetese.

L.M. kërkon të bëjë zgjidhjen e martesës dhe të marrë kujdestarinë e vajzes së saj së mitur. Duke u nisur nga kushtet shumë të vështira ekonomike të L.M. dhe niveli i ulët arsimor i saj, TLAS mori përsipër që jo vetëm të ndjekë procedurat gjyqësore të zgjidhjes së martesës, por edhe ta ndihmojë atë në grumbullimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

Për të bërë zgjidhjen e martesës, në gjykatë duhet të paraqiten këto dokumenta:

1. Çertifikatë personale me fotografi e personit që kërkon zgjidhjen e martesës;
2. Çertifikatë personale pa fotografi e bashkëshortit tjetër;
3. Çertifikatë martese;
4. Çertifikatë familjare;
5. Çertifikatë personale pa fotografi, e secilit prej fëmijëve nën moshën 18 vjeç, nëse çifti ka fëmijë.

L.M. mori çertifikatat e kërkuara nga zyra e gjendjes civile, por gjatë shqyrtimit të tyre, u vu re se në çertifikatën e martesës mungonte data e martesës. Data e martesës është një nga përbërësit kryesorë të çertifikatës së martesës dhe pa këtë datë çertifikata nuk është e vlefshme. Mbas interesimit tonë pranë zyrës

së gjendjes civile të Njesisë Bashkiake Nr. 5, ku L.M. figuron e regjistruar, u vu re, se në të dhënat e saj në regjistrin themeltar, mungonte kjo e dhënë. Duke kontrolluar për të dhëna të tjera, pamë se ajo, së bashku me familjen e saj, ishte transferuar në këtë njësi, në vitin 1994, nga komuna Paskuqan. Në regjistër jepej edhe numri rendor i regjistrimit të saj të mëparshëm në regjistrat themeltarë të gjendjes civile të Komunës Paskuqan.

Mbas takimit me punonjësit e gjendjes civile të Komunës Paskuqan dhe kontrollit të regjistrit në numrin përkatës rendor, u pa që kjo shtetase, ishte transferuar së bashku me familjen në këtë komunë, nga Yzberishi, në vitin 1988. Në regjistër gjetëm edhe numrin e regjistrimit të saj në Yzberish. Mbas disa kërkimesh, u vumë në dijeni se në vitin 1988, Yzberishi ishte pjesë e Kasharit. Aty ishin edhe të dhënat e Kamzës, në atë kohë Ndërmarrje Bujqësore Shtetërore.

Për të marrë certifikatën e plotë të martesës të L.M., duhet të drejtoheshim në zyrën e gjendjes civile të Prefekturës së Tiranës, ku ruhet arkivi i të gjitha librave të akteve të gjendjes civile, përfshirë ato të martesës, për rrethin e Tiranës. Por aktet ruhen në libra të veçantë, sipas çdo viti dhe për të marrë një kopje nga akti, duhet të dihej të paktën viti i martesës. L.M. nuk mbante mend vitin e saktë të martesës dhe për këtë arsye kërkimi ishte shumë i vështirë. Për të gjetur vitin e martesës duhet të merreshin të dhëna nga regjistrat e komunës Kashar.

Mbas kontaktimit të punonjësës së zyrës së gjendjes civile të Komunës Kashar dhe kontrollit të regjistrit themeltar të shtetasve në numrin rendor të familjes së L.M., u konstatua që kjo familje kishte ardhur nga Kamza dhe martesa ishte bërë në vitin 1986. Morëm datën e saktë të martesës dhe numrin e aktit të martesës. Me këtë informacion u drejtuam në zyrën e arkivit të Prefekturës Tiranë dhe më në fund tërhoqëm certifikatën e martesës, të plotësuar me të gjitha të dhënat.

Kjo anomali ishte krijuar për shkak se gjatë transferimi fillestar të familjes, punonjësi i gjendjes civile nuk kishte dërguar në zyrën e vëndbanimit të ri, edhe datën dhe numrin e aktit të martesës, sipas detyrimit ligjor. Për këtë arsye, në çdo transferim të mëvonshëm, mungonte ky informacion.

Mbas marrjes së certifikatës së martesës, TLAS ka filluar procedurat gjyqësore për zgjidhjen e martesës së çiftit dhe marrjen e kujdestarisë së fëmijës

nga ana e nënës. Ndhima e TLAS për plotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për gjykatën ishte e domosdoshme, sepse L.M. nuk mund ta realizonte e vetme këtë detyrë.

Rasti i Klientes R.S.

R.S. jeton në një çadër të ngritur pranë liqenit artificial të Tiranës, së bashku me tre fëmijët e saj dhe me personin me të cilin ajo bashkëjeton. Ata e nxjerrin bukën e gojës nga shitja e sendeve të ndryshme, që grumbullojnë nga kazanët e hedhjes së mbeturinave. Ajo ka një fëmijë 3 muajsh të paregjistruar ende në gjendjen civile, të lindur nga bashkëjetesa me Z.I. Ndërkohë R.S. ligjërisht figuron e martuar me një tjetër person, me të cilin ka dy fëmijë. Këta fëmijë janë të regjistruar në gjendjen civile.

R.S. u drejtua në TLAS për të pyetur se si duhet të vepronte për të regjistruar fëmijën e saj. Nga ana jonë ajo u sqarua se në bazë të legjislacionit në fuqi, kur të regjistrohej fëmija, do të merrte automatikisht mbiemrin e bashkëshortit legal të nënës së tij dhe më vonë, nëpërmjet gjykatës do bëhej kundërshtimi i atësisë së fëmijës dhe njohja e atësisë së vërtetë të tij. Për ndjekjen e të gjithë këtyre procedurave, ajo do mbështetej nga avokatët e TLAS.

R.S. kërkon të bëjë zgjidhjen e martesës nga bashkëshorti i saj, meqë ai e keqtrajton dhe nuk kujdeset për mbarëvajtjen e familjes dhe të fëmijëve. Ajo dëshiron që më vonë të lidhë martesë me Z.I. që është edhe babai i fëmijës së saj të tretë dhe me të cilin ka krijuar një jetë më të mirë.

Për të normalizuar gjendjen e familjes së R.S. duheshin bërë disa ndërhyrje urgjente. TLAS ka filluar nga puna për realizimin e të gjithë hapave të nevojshëm:

1. Regjistrimi i fëmijës së tretë në regjistrin e gjendjes civile. Duke qënë fëmija i regjistruar dhe me identitet të përcaktuar do fillohet në një fazë tjetër kundërshtimi i atësisë.
2. TLAS ndihmoi R.S. që të grumbullojë të gjitha çertifikatat e nevojshme të gjendjes civile (7 copë) dhe të fillojë procedurat gjyqësore për zgjidhjen e martesës nga bashkëshorti dhe marrjen e kujdestarisë së dy fëmijëve nga nëna.
3. Mbas realizimit të zgjidhjes së martesës, kur R. S. të figurojë si kryefamiljare me tre fëmijë, TLAS do ta ndihmojë të përgatisë dokumentacionin për përfshirjen në skemën e përfitimit të përkrahjes sociale në njësinë bashkiake ku ajo është e regjistruar. Për këtë duhet të merret një çertifikatë e gjendjes civile, për përkrahjen sociale.

Njëkohësisht do përgatisim dokumentacionin që familja e saj të regjistrohet në njësinë bashkiake si e pastrehë, për t'i krijuar mundësinë për të përfituar nga programet e strehimit që kanë filluar të zbatohen nga Bashkia e Tiranës. Për këtë TLAS do ta ndihmojë në plotësimin e formularit tip të kërkesës për t'u trajtuar me strehim, që më pas do të noterizohet dhe do të dorëzohet në njësinë bashkiake, kundrejt një pagese. Duke parë pamundësinë e saj ekonomike, TLAS do të bëjë edhe pagesën e të gjitha shpenzimeve të nevojshme.

Historia 5

Rasti i Klientes S.Ll

S.Ll. ka dy fëmijë dhe që të dy ishin të peregjistruar në gjendjen civile. Vajza e saj M. ishte madhore kur lindi dy fëmijë, por nuk mund t'i regjistronte as ata, meqë ajo vetë ishte e peregjistruar. Pra në familjen e S.Ll. kishte katër persona të peregjistruar në gjendjen civile. S.Ll. nuk kishte asnjë dokument nga materniteti për të dy fëmijët e saj. Të gjithë këta persona kishin mbetur pa u regjistruar, për shkak se S.Ll. nuk kishte shkuar të deklaronte lindjen e dy fëmijëve të saj brenda afateve ligjore të përcaktuara dhe në bazë të ligjit të gjendjes civile, që ishte në fuqi në atë kohë, ajo duhet të bënte konfirmimin e lindjeve nëpërmjet gjykatës dhe të paguante gjobë për secilin prej fëmijëve. S.Ll. nuk mund ta ndiqte këtë problem me gjykatë, për shkak të pamundësisë ekonomike për të paguar një avokat. Ajo nuk mund të paguante as gjobën e përcaktuar nga ligji. Dhe kështu fëmijët e saj kishin mbetur pa u regjistruar dhe për më tepër, vajza e saj e madhe lindi dy fëmijë që mbetën edhe ata pa u regjistruar. Pra S.Ll. kishte edhe dy fëmijë edhe dy nipër të peregjistruar në gjendjen civile.

Mbas ndryshimit të ligjit të gjendjes civile në korrik 2008, u bë i mundur regjistrimi i çdo personi, në çdo kohë, pa patur afate ligjore të raportimit të lindjes. TLAS e kontaktoi S.Ll. në një ndër takimet e organizuara në komunitet dhe aty mësoi për problemet e saj. Duke u nisur nga datat e përafërta të lindjes së fëmijëve, të dhëna prej saj, morëm nga Materniteti Nr. 1 i Tiranës publikatat e lindjes së dy fëmijëve. Kështu u bë i mundur regjistrimi i fëmijëve në regjistrat e gjendjes civile.

TLAS po vazhdon tashmë procedurat për regjistrimin e lindjes së dy nipërve të S.Ll., që janë fëmijët e M. Regjistrimi i këtyre fëmijëve në gjendjen civile paraqet vështirësi, sepse M. në maternitet nuk ka dhënë mbiemrin e saj real, por atë të babait të saj biologjik B.Xh., që në fakt nuk e ka bërë njohjen e atë-

sisë. Pra në të dy certifikatat e asistencës në lindje të lëshuara nga materniteti i Tiranës për të dy fëmijët, nuk figuron mbiemri real i M.

TLAS mori informacion që babai i M. punonte si emigrant jashtë shtetit dhe mundi të sigurojë numrin e tij të telefonit. Mbas një bisede telefonike me të, B.Xh. na siguroi që do të vinte brenda vitit 2008 në Shqipëri dhe do bënte njohjen e atësisë së vajzës së tij M. Mbas njohjes së atësisë dhe ndryshimit të mbiemrit të M. do të bëhet i mundur edhe regjistrimi i dy fëmijëve të saj.

Rasti i klientes S. B:



S.B është kryefamiljare e cila ka punuar për 28 viteve dhe nuk ka mundur të përfitojë pension të pjesshëm pleqërie shtetërore. Klientja S.B kishte punuar 23 vite në Ndërmarrjen e Prodhimeve Artistike, Tiranë dhe 5 vite pune në Kooperativën Bujqësore Maminas. Nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Dega Tirane iu njoh e drejta për pension të pjesshëm pleqërie kooperative. Klientja S.B. nuk ishte dakord me vendimin

e marrë nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve, pasi ajo kishte punuar pjesën më të madhe në ndërmarrje shtetërore. Për këtë arsye ajo u paraqit pranë zyrës sonë, në mënyrë që të gjente një zgjidhje për problemin e saj.

Avokati i TLAS-it pasi e shqyrtoi çështjen arriti në përfundimin se klientia kishte të drejtë në kërkimin e saj. Ligji Nr 7703 “Për sigurimet shoqërore” parashikon se për të përfituar pension të pjesshëm pleqërie shtetëror personi duhet të ketë mbushur moshën për pension dhe të ketë bërë jo më pak se 20 vite pune nga të cilat 17 vite pune të jenë në marrëdhënie me shtetin.

Klientia në librezën e saj të punës ka të dokumentuar 28 vite pune nga ku 23 i ka pasur në marrëdhënie me shtetin.

Por nga Drejtoria e Rajonale e Sigurimeve Shoqërore “nuk është marrë në konsideratë një pjesë e periudhës së punës në Ndërmarrjen Artistike nga 16.03.1970 – 16.03.1977, pasi siç rezulton nga vërtetimi i arkivës në dt. 27.03.2008, viti i fillimit është i korrigjuar “dhe për rrjedhojë nuk i është njohur e drejta për pension të pjesshëm pleqërie shtetëror”.

Argumenti i përdorur nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, është i pambështetur në ligj, pasi klientia dispononte librezën e punës origjinale e cila përfaqëson një dokument zyrtar dhe si e tillë ajo mund të kundërshtohet vetëm “për falsitet” (neni 253 i Kodit të Procedurës Civile).

Në këto kushte avokati i TLAS-it, filloi punën për t'i ardhur në ndihmë klientes. Si fillim u hartua kërkesa ankimore pasi duhet që të ezaurohet rruga administrative e ankimit, dhe më pas nëse çështja nuk merr zgjidhje administrativisht ajo do të trajtohet në rrugë gjyqësore.



Rasti i Klientes V. I:

Pranë Zyrës tonë rreth 1 vit më parë u paraqit një kliente e komunitetit Rom të qytetit të Elbasanit me initiale V.I. Pasi ishte njohur me shërbimet që kryente zyra jonë, nëpërmjet personave të tjerë dhe nëpërmjet fletëpalosjeve të shpërndara për veprimtarinë e zyrës pranë qendrave ku banon kjo pjesë e popullsisë, ajo u paraqit duke kërkuar regjistrimin e lindjes së tre fëmijëve të saj.

Pasi u arrit të kontaktohej me klienten V.I dhe pas një interviste me të u identifikuan problemet e saj.

Nga intervista u konstatua se klientja V.I kishte lindur tre fëmijë jashtë martese me shtetasin Gj.K dhe pavarësisht se lindjet kishin ndodhur në institucionet e njohura nga ligji ato nuk ishin deklaruar përpara nënpunësit të gjendjes civile. Gjithashtu nga intervista me klienten V.I u konstatua se një ndër shkaqet që kishin penguar regjistrimin e fëmijëve të saj ishte pikërisht fakti se klientja V.I e kishte vendbanimin në qytetin e Beratit si dhe fakti i mosnjohjes së ligjit Personi me të cilin ajo bashkëjetonte nuk ndodhej në Shqipëri dhe ajo nuk mund të shkonte në Berat për shkak hasmërie.

U paraqit çështja në mbledhjen e radhës së Zyrës dhe nga diskutimet u arrit në përfundimin se përveç faktit të regjistrimit të fëmijëve të saj klientja V.I kishte shprehur dëshirën që të transferonte gjendjen e saj familjare nga qyteti i Beratit në qytetin e Elbasanit, gjithashtu kërkonte që të lidhte martesë ligjore me shtetasin Gj.K.

U shqyrtua rasti dhe u mendua që fillimisht të transferonim gjendjen familjare të klientes V.I në Elbasan dhe më pas të procedonim me regjistrimin e fëmijëve pranë zyrës së gjendjes civile të Elbasanit. Përsa i përket faktit që kërkuësja kishte shprehur dëshirën për të lidhur martesë me shtetasin Gj.K, kjo gjë ishte e pamundur të bëhej për sa kohë shtetasi Gj.K qëndronte jashtë Shqipërisë, pasi ligji i kërkon të dy bashkëshortët e ardhshëm që të paraqiten përpara nënpunësit të gjendjes civile dhe të nënshkruajnë personalisht aktin e martesës. Kështu u mendua që të procedohej me dy hapat e tjerë.

Duke qenë se klientja V.I kishte probleme hasmërie në Berat u mendua që

të përpilohej një prokurë ku ajo të autorizonte një nga avokatët e zyrës që të realizonte të gjitha procedurat e nevojshme për transferimin e gjendjes civile të saj në qytetin e Elbasanit. Pasi u përpilua prokura, dy nga avokatët e zyrës shkuan në qytetin e Beratit por nga zyra e gjendjes civile të Beratit u kundërshtua transferimi duke e refuzuar në këtë mënyrë kërkesën e klientes V.I, me arsyetimin se për të kryer veprimet e transferimit duhet të paraqitet vetë personi.

Pas diskutimeve të shumta u mendua që të shkohej një ditë bashkë me klienten V.I në qytetin e Beratit duke marrë parasysh faktin që klientja e kishte të vështirë të paraqitej për shkaqet e përmendura më sipër, për të kryer procedurat e nevojshme për transferim.

Pasi shkuan në qytetin e Beratit dhe u paraqitëm në Zyrat e Gjendjes Civile, klientja V.I ishte në një trung familjar me pesë persona të tjerë. U mendua që të kryente procedurat e veçimit familjar pasi ligji ja njeh këtë të drejtë çdo personi që ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç. Pasi u realizua veçimi u morën certifikatat e nevojshme për të realizuar transferimin e gjendjes familjare të klientes V.I.

Të gjitha këto dokumente u paraqitën në zyrën e gjendjes civile të Elbasanit që i takonte vendbanimit të kërkuësës duke u shoqëruar edhe me një kërkesë nga ana e saj për të bërë të mundur transferimin.

Pasi u plotësuan afatet ligjore u arrit të bëhej i mundur transferimi i gjendjes civile të kërkuësës në qytetin e Elbasanit.

Më pas u procedua me regjistrimin e fëmijëve në gjendjen civile, pasi i mbledhëm të gjitha certifikatat e lindjes së fëmijëve bashkë me kërkuësen u paraqitëm në zyrat e gjendjes civile dhe me dokumentat e maternitetit arritëm të bëjmë të mundur regjistrimin e fëmijëve në fletën familjare të nënës së tyre. Kështu këta fëmijë mund të gëzojnë dhe të përfitojnë të gjitha të drejtat që ligji ua njeh atyre.

Vlen të theksohet se problemet që kemi hasur gjatë punës me popullsinë Rome janë mjaft të ndërlikuara, por pavarësisht këtyre pengesave Shërbimi Ligjor Falas Tiranë ka bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme që t'i vijë në ndihmë jo vetëm komunitetit Rom të Tiranës por edhe atij komuniteti që banon në qytete të tjera të Shqipërisë.

Historia 7

Rasti i klientes K.N.

Pranë Zyrës tonë rreth 1 vit më parë u paraqit një kliente me inicialet K.N, pasi ishte njohur me shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të

tjerë. Ajo u paraqit duke kërkuar pension ushqimor për djalin e saj të mitur të lindur jashtë martese, pasi babai i fëmijës pavarësisht se e kishte njohur atësinë e fëmijës nuk pranonte të kontribuonte në mirërritjen e fëmijës.

Janë pikërisht këto raste të cilat po shtohen dita ditës në shoqërinë Shqipëtare, pasi siç dihet është rritur mjaft numri i martesave të faktit (martesa jo në kuptimin ligjor, bashkjetesë), dhe janë pikërisht këto probleme që hasen pas ndërprerjes së bashkjetesës. Pasi fëmija jeton me njërin nga prindërit dhe fakti se fëmija nuk jeton me prindin tjetër nuk e shkarkon atë nga detyrimi për të kontribuar për një jetesë më të mirë të fëmijës së tij.

U procedua me mbledhjen e dokumentave të nevojshëm të cilat vërtetënin faktin që fëmija jetonte me nënën dhe të gjithë dokumentat që u konsideruan të nevojshëm për fillimin e procesit gjyqësor.

U mendua që të hartohej një kërkesë-padi duke u thirrur si i paditur në gjykim i ati i fëmijës.

Vetë termi bashkjetesë është shumë i përdorur këto vitet e fundit por sipas nenit 163 të Kodit të Familjes: “Bashkjetesë është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie”.

Për fëmijët e lindur jashtë martese neni 170 i Kodit të Familjes parashikon: “Amësia dhe atësia e fëmijës së lindur jashtë martese mund të vendosen me anë të njohjes vullnetare ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor dhe për prindërit krijon te drejta dhe detyrime të njëjta, në mënyrë prapavepruese, si për fëmijët e lindur nga martesa”. Pra nga neni i mesipërm kuptohet qartë se edhe fëmijët që janë fryt i bashkjetesës gëzojnë të njëjtat të drejta si fëmijët e lindur nga martesa dhe prindërit e tyre kanë të njëjtat detyrime njësoj si për fëmijët e lindur nga martesa.

Sipas nenit 192 pika “b” e Kodit të Familjes “Detyrim për ushqim kanë prindërit ndaj fëmijës së tyre”, pavarësisht nëse fëmija ka lindur jashtë martese apo nga martesa, madje neni 196 përmend faktin se edhe në qoftë se njërit nga prindërit i është hequr përgjegjësia prindërore, përsëri ai nuk mund të shmanget detyrimit për ushqim ndaj fëmijës së tij.

Neni 197 parashikon “Prindërit kanë detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve të tyre, kur këta nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar. Një fëmijë i mitur mund t’u kërkojë prindërve të tij detyrimin për ushqim edhe kur ka pasuri, kur të ardhurat nga pasuria dhe nga puna e tij nuk i përmbushin nevojat e tij.

Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën njëzetepesë vjeç”.

Pra, duke iu rikthyer rasis të klientes K.N, duke marrë parasysh moshën e

mitur të djalit të saj dhe vështirësinë financiare në të cilën ajo ndodhej, ajo në bazë të të gjithë neneve të përmendur më lart përligjej plotësisht në kërkimin e saj, duke kërkuar një jetë më të mirë për fëmijën e saj.

U depozitua kërkesë-padia në gjykatë dhe u procedua me hapat e mëtejshëm, ku u zhvilluan disa seanca gjyqësore dhe gjykata arriti në përfundimin se klientja K.N kishte të drejtë në kërkimin e saj duke i lidhur në këtë mënyrë një pension fëmijës së klintës K.N.

Në këtë mënyrë ky fëmijë do të ketë një të ardhme më të mirë dhe do të ketë mundësi më të mëdha për të pasur një jetesë normale njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë.

Mbas një pune pothuajse 2-vjeçare duke vlerësuar dhe kontributin e madh të Shërbimit Ligjor Falas Tiranë u arrit në përfundimin e dëshiruar nga klientja K.N.

E. TREGUESIT E SUKSESIT TË RASTEVE

Shërbimet Ligjore:



Gjatë vitit 2008, përqindja e suksesit në çështjet ligjore u rrit më tej, në krahasim me vitet e mëparshme. Përqindja e suksesit për periudhën Janar – Dhjetor 2008 llogaritet duke u bazuar në çështjet që janë trajtuar nëpërmjet përfaqësimit në gjykatë dhe veçanërisht ato të cilat kanë përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Për çështjet e tjera ligjore, të cilat janë trajtuar nëpërmjet këshillimit, hartimit të dokumenteve, ose shërbimit *clinics*, kuptohet që ato janë quajtur si të suksesshme në kuptimin që klienti ka përfituar këshillimin e kërkuar nga TLAS.

Përqindja e suksesit të çështjeve ligjore të TLAS, të cilat janë trajtuar nëpërmjet përfaqësimit në gjykatë, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2008 ka qënë 95 (nëntëdhjetë e pesë) % (kjo përqindje është llogaritur duke patur parasysh numrin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë të marra gjatë kësaj periudhe për këto çështje). Gjatë vitit 2008, në gjykatë janë përfaqësuar 390 raste, 35 prej të cilave janë ende në proces gjyqësor, (ku për 350 raste është dhënë vendimi; 342 kanë qënë të suksesshme, 6 janë në Gjykatën e Apelit, 9 çështje janë pushuar dhe nuk ka çështje të humbura).

Shërbimet Paraligjore:



Sipas vlerësimit të të dhënave të TLAS, del se komunitetet vulnerabël kanë shumë nevojë për informim dhe edukim ligjor, për hartim dokumentash si edhe për përfaqësim në nivele të ndryshme të administratës shtetërore. Gjatë 2008, këshilltarët e TLAS kanë administruar 956 çështje paraligjore dhe kanë zgjidhur në favor të përfituesve **86% (tetëdhjetë e gjashtë përqind)** të rasteve.

Shërbimi Ligjor përmes telefonit, Lawline

Ky lloj shërbimi ka filluar të funksionojë në 1 Dhjetor 2001, i lejon cdo individ të përfitojë shërbim ligjor falas. Janë bërë përpjekje, që nëpërmjet, fletëpalosjeve dhe intervistave radiofonike, ky shërbim t'i bëhej i ditur popullsisë, veçanërisht në zonat rurale. Në zonat rurale të Tiranë janë bërë shpërndarje të vecanta të fletëpalosjeve. Gjatë vitit 2008, në këtë shërbim u regjistruan 467 raste të reja (vetëm ata që kanë përfituar shërbim telefonik, pa llogaritur numrin e klientëve që përfitojnë shërbim në zyrat e TLAS). Këta të fundit janë llogaritur në numrin total të klientëve që kanë përfituar shërbime pranë TLAS. Gjithashtu në numrin prej 467 telefonuesish, nuk llogariten telefonatat e klientëve që kanë hapur çështje në TLAS dhe që kontaktojnë e ndjekin çështjen e tyre në mënyrë të rregullt me stafin. Besimi ndaj shërbimeve të ofruara nga TLAS është rritur jo vetëm te individët në nevojë që telefonojnë por edhe nga numri në rritje i përfaqësuesve të organizatave të ndryshme që kontaktojnë përmes telefonit avokatët e TLAS. Një pjesë e mirë e telefonuesve të TLAS në përputhje me nevojat që kanë janë burim i klientëve potencial, ata paraqiten në vazhdim personalisht në zyrat e TLAS, pas këshillimit telefonik, për të përfituar direkt shërbim falas.

Clinics:



Gjatë vitit 2008 u trajtuan me shërbimin clinics 418 raste, ku individët të cilët kanë një nivel të caktuar arsimor dhe njohuri fillestare ligjore paraqiten vetë përpara gjykatës për të përfaqësuar rastet e tyre.

E. NDIKIMET E PROJEKTIT NE MJEDISIN RRETHUES

Zbatimi i Projektit të TLAS ka patur ndikimin e tij në përdorimin e sistemit të drejtësisë nga individët në nevojë. TLAS ka bërë të mundur zbatimin e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor dhe veçanërisht të elementit të tij kryesor, të drejtën e aksesit në gjykatë. Këto janë të drejta kushtetuese. Personat, të cilët nuk kanë mundësi financiare të pajtojnë një avokat, kanë fituar aksesin në gjykata në sajë të TLAS dhe për pasojë kanë përdorur në mënyrë efikase sistemin gjyqësor. TLAS i ofron njerëzve në nevojë mundësinë për të përfituar nga ekspertiza e avokatëve të tij. Kështu, TLAS ndihmon në respektimin e të drejtës së individit për akses në gjykatë, në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Miratimi i Ligjit “Për Ndihmën Juridike” do të krijojë kuadrin e nevojshëm ligjor dhe institucional për rritjen e aksesit të shtresave në nevojë në shërbimet ligjore dhe ato sociale. Në këtë mënyrë individët në nevojë do të kenë mundësinë të paraqesin rastet e tyre dhe të mbrohen nëpërmjet një shërbimi të financuar nga shteti.

Nëpërmjet nxitjes së *ndërmjetësimit* (për zgjidhjen e konflikteve me pajtim), TLAS ka ndikuar në pakësimin e konflikteve sociale.

TLAS përfaqëson mundësinë reale të njerëzve në nevojë për të zgjidhur problemet e tyre dhe mosmarrëveshjet, në bazë të opinioneve ligjore, zgjidhjeve administrative apo sistemit gjyqësor.

Një nga problemet më të mëdha në Shqipëri është zbatimi i ligjit. Problemi është më i dukshëm për njerëzit në nevojë, ndaj të cilëve shteti tregohet indiferent, por për të cilët edhe shoqëria civile tregon shenja neglizhence. Veprimtaria e TLAS i kundërvihet këtij realiteti. Megjithatë, pa një ndërhyrje të mirëfilltë të të gjithë segmenteve të shtetit, ky do të vazhdojë të jetë një problem shqetësues për drejtësinë dhe shoqërinë shqiptare.

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) jep ndihmesën e tij në përmirësimin dhe rritjen e kulturës demokratike tek qytetarët. Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme të ndërgjegjësimin, të llojit të street law, qytetarët edukohen të mbrojnë të drejtat e tyre ligjore, si të komunikojnë me strukturat shtetërore, si dhe si të përdorin në mënyrë demokratike dhe institucionale legjislacionin, shtetin dhe strukturat e shoqërisë civile. Gjithashtu, TLAS jep kontributin e tij në forcimin e demokracisë dhe shtetit ligjor në Shqipëri, nëpërmjet përpjekjeve të tij për nisma në përmirësimin e legjislacionit ekzistues.

TLAS po përpaket të ndërgjegjësojë shtetin shqiptar për një sistem ligjor efikas në Shqipëri dhe ka filluar përpjekjet për krijimin e një sistemi formal mekanizmash për ofrimin e ndihmës ligjore në Shqipëri. TLAS po ndihmon në krijimin e besimit se shoqëria nuk i ka neglizhuar njerëzit në nevojë, por përkundrazi i respekton ata si njerëz me të drejta dhe liri natyrale themelore.

F. MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

a) PRAKTIKAT E MENAXHIMIT

i) Struktura Organizative

TLAS ka një strukturë organizative me kufij të përcaktuar qartë të kompetencave dhe përgjegjësi. Aktualisht TLAS ka një strukturë organizative të përbërë nga 10 pozicione: Drejtori Ekzekutiv i Qendrës, drejtuesi i Projektit, dy avokatë, dy avokatë/këshilltarë paraligjorë, një këshilltare programi, një punonjëse administrate/finance, një arkëtare dhe një pastruese me kohë të pjesshme. Funksionimi organizativ i TLAS shqyrtohet rregullisht.

Praktikat e menaxhimit të TLAS pasqyrojnë paanshmërinë, konfidencialitetin dhe profesionalizmin të përshkruar në projekt-propozime. Gjithashtu, përdoren sisteme për vlerësimin periodik të përputhjes së misionit të projektit dhe funksionimit të përditshëm të TLAS. Nga ana tjetër, përdoren sisteme për të garantuar përfshirjen e të gjithë niveleve të stafit në vendimmarrje. Politikat

dhe procedurat e TLAS garantojnë përgjegjshmërinë përpara subjekteve të interesuara për TLAS.

ii) Planifikimi

Gjatë procesit të planifikimit, merren parasysh edhe opinionet dhe rekomandimet e të interesuarve. Planet e zbatimit bazohen në planifikimin strategjik dhe përditësohen sipas nevojave dhe kushteve. Burimet shpërndahen në mënyrën e duhur dhe planet e aktiviteteve rregullohen e përmirësohen në bazë të procesit të monitorimit.

iii) Menaxhimi i rasteve

Rezultatet e proceseve të monitorimit dhe vlerësimit kërkojnë dhe çojnë në ndryshime të menaxhimit të rasteve. Duhet të theksohet se sistemet e menaxhimit të rasteve i përgjigjen nevojave dhe efikasitetit të të interesuarve, përshtatjes së kostove dhe realizimit në afat.

iv) Procedurat Administrative

Zbatimi i politikës administrative të TLAS është në përputhje me ato të Rregullores së miratuar nga Bordi Drejtues i TLAS.

vi) Sistemet e Informimit

Për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave përdoren disa sisteme. Të dhënat e mbledhura për analiza dhe raportim janë të përshtatshme për përmbushjen e aktiviteteve; personel i trainuar administron sistemin e informimit. Gjithashtu, sistemet përdoren për të përpunuar, shpërndarë dhe kërkuar opinion dhe rekomandime.

vii) Raportimi

TLAS përmbush të gjitha kërkesat për raportim (raporti vjetor i dërgohet CAFOD UK dhe donatorëve të tjerë). Gjatë vitit 2008, 4 raporte iu dërguan CAFOD UK (**Mars, Qershor, Shtator, Dhjetor**); 2 raporte iu dërguan CCF (**Qershor, Dhjetor**); 6 raporte SHC (**2 për secilin projekt në Shkurt, 2 në Gusht, 2 në Nëntor**); 3 raporte Terre des Hommes (**Mars, Qershor, Shtator**); 2 raporte UNICEF (**Maj, Gusht**); 2 raporte SOROS (**Tetor, Dhjetor**); në total 19 raporte.

Gjithashtu, gjatë vitit 2008 veprimtaria e TLAS është audituar 5 here: një Raport Auditimi për gjithë veprimtarinë financiare të Programit, një Raport Auditimi për performancën e programit nga Firma Fabel, Werner & Schintke dhe tre Raporte Auditimi financiare të vecanta rreptësisht për projektet e financuara nga SHC, SOROS dhe Ambasada Amerikane.

b) BURIMET NJERËZORE

i) Zhvillimi i Burimeve Njerëzore

Trainimi i stafit të TLAS bazohet në kapacitetin, nevojat dhe objektivat strategjike. Aftësitë e fituara gjatë trainimeve përshtaten me mjedisin e punës së TLAS. Vlerësimet e punës bazohen në performancën dhe arritjet. Nevojat e stafit identifikohen vazhdimisht dhe ato përmbushen gjatë vitit në përputhje me Projekt Buxhetin përkatës dhe mundësitë e financimit. Të gjitha licencat e avokatëve u rinovuan për vitin 2008.

ii) Menaxhimi i Burimeve njerëzore

Përshkrimet e punës janë dokumentuar, përditësuar dhe zbatuar. Struktura e stafit është e përshtatshme për të përmbushur misionin e TLAS. Struktura e pagave është miratuar në vitin 2008 nga Bordi Drejtues i TLAS. Mbikqyrja e stafit të TLAS bëhet rregullisht.

iii) Organizimi i Punës

TLAS zhvillon mbledhje të rregullta stafi, që kanë ndihmuar në përmirësimin e procedurave dhe efikasitetin e administrimit & menaxhimit të programit. Marrja e vendimeve nga ana e stafit drejtues të TLAS bazohet edhe në opinionin e stafit. Stafi në përgjithësi punon si ekip i mbështetur nga një atmosferë besimi, bashkëpunimi e bashkëpunimi i cili konsiderohet baza e sukseseve dhe e vetmotivimit. Informacioni shpërndahet lirisht dhe stafi nxitet e përkrahët në ndërmarrjen e nismave për përsosjen e metodologjisë së punës.

c) BURIMET FINANCIARE

i) Llogaritë

TLAS përdor procedura financiare dhe sisteme raportimi që kanë funksionuar plotësisht. Gjatë 2008, vëmendje e veçantë i është kushtuar kryerjes së shpen-

zimeve përmes transfertave bankare, në mënyrë që të minimizohet kryerja e shpenzimeve përmes shlyerjes në cash. TLAS Për arsye të përdorimit sa më efikas të monedhave si dhe të raportimit, TLAS mban llogari të vecanta për monedha të ndryshme.

ii) Buxheti

Procesi i buxhetit është përfshirë në planin vjetor të zbatimit. Zbatimi i buxhetit kontrollohet vazhdimisht.

iii) Inventari

TLAS ka ngritur sisteme të kontrollit të materialeve të magazinuara dhe këto sisteme zbatohen. Në Shkurt 2009 u përgatit dhe u dokumentua lista e re e inventarit të sendeve për vitin 2008. Për blerjet dhe shitjen e aseteve të zyrës janë ngritur sisteme prokurimi të përshtatshme. Shpenzimet në bazë të buxhetit kontrollohen vazhdimisht.

iv) Raportimi financiar


Raportet financiare të TLAS përgatiten dhe përdoren për qëllim planifikimi dhe vlerësimi. Raporti financiar i TLAS është i disponueshëm dhe i dërgohet të gjithë donatorëve të TLAS.

v) Ngritja e Fondeve

Gjendja financiare e projektit ka qenë një prioritet i drejtimit dhe administrimit të TLAS. Gjatë hartimit të këtij raporti janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me donatorët aktualë dhe ata të mundshëm si dhe ka vazhduar procesi i nënshkrimit të kontratave të reja.

Është nënshkruar nga CAFOD UK kontrata për 2009, janë nënshkruar edhe kontratat me UNICEF, SOROS/OSFA Budapest, Komitetin Suedez të Helsinkit, UNDP, USAID, si dhe janë paraqitur projekt propozime të reja në Ambasadën Amerikane, SHC, etj, për t'i paraprirë mbështetjes financiare të TLAS gjatë vitit 2009- 2010.

**FINANCIMI I TLAS NE VITE
1999 - 2008**



d) MARREDHENIET ME JASHTË

i) Marrëdhëniet Publike

TLAS e edukon publikun mbi çështje të veçanta ligjore. Ai përdor fushatat e ndërgjegjësimi të publikut dhe bashkëpunimin me zyrat e tjera të ndihmës ligjore falas.

TLAS përpaket të mbajë marrëdhënie me institucione të ndryshme, organizata jofitimprurëse dhe donatorë të ndryshëm, duke përdorur metoda të ndryshme të marrëdhënieve publike.

ii) Bashkëpunimi me organet shtetërore

Hartuesit e politikave kanë filluar t'i konsiderojnë opinionet e TLAS për çështje të ndryshme ligjore. Çdo ditë e më tepër organet shtetërore e njohin TLAS si një mbrojtës legjitim të të drejtave të njeriut. Viti 2008 i ngriti në një shkallë më lart marrëdhëniet e TLAS me Ministrinë e Drejtësië, Ministrinë e Brëndshme, Ministrinë e Punës dhe Cështjeve Sociale, me Avokatin e Popullit, me Bashkitë dhe Gjykatat në të gjithë vendin, etj. Numri i madh i klientëve që janë përcjellë nga strukturat shtetërore, marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara me TLAS për këtë qëllim, si dhe projektet e përbashkëta flasin

për nevojën, vlerësimin, mbështetjen dhe domosdoshmërinë e shërbimeve ligjore falas në realitetin e sotëm. Pjesëmarrja e TLAS në ngjarjet e rëndësishme të komunitetit ligjor, të organizuara nga organet shtetërore dhe organizatat ndërkombëtare është një tregues i peshës së opinioneve dhe rekomandimeve të TLAS për thellimin e reformës në drejtësi dhe në fushën sociale.

iii) Media

TLAS ka filluar të përdorë një strategji për publikimin e punës së tij në media. Përpjekjet për publikimin e kësaj pune në shtypin e përditshëm dhe në Televizion dhe emisionet radiofonike (sic janë përmendur më lart) janë hapat për zbatimin e kësaj strategjie. Nga ana tjetër, media e përdor TLAS si burim për çështje të rëndësishme ligjore e sociale.

iv) Publikimet

Kujdes është treguar për publikimin e aktivitetit të TLAS. Janë publikuar tre numra të revistës së TLAS – (nr.1/2008, 2/2008, 3/2008) dhe një numër i madh materialesh propagandistike si leaflet, postera, fletëvolante, etj. Gjatë vitit 2008, TLAS publikoi vëzhgimet dhe raportet analitike statistikore të cilat mund t'i gjeni bashkëlidhur si shtojca të këtij Raporti Vjetor.

1. Statistika dhe Analiza krahasuese për 2008, raport që bazohet në të dhënat e regjistruara në bazën e të dhënave të klientëve të TLAS, të cilët kanë përfituar shërbim nga TLAS gjatë katër viteve të fundit.
2. Statistika dhe analize krahasuese për klientet Rome 2008, raport që bazohet në të dhënat e regjistruara në bazën e të dhënave të klientëve të TLAS vetëm për klientët e komunitetit ROM, të cilët kanë përfituar shërbim nga në katër vitet e fundit.
3. Raporti monitorimit të nivelit të kënaqësisë së përdoruesve të Gjykatave (vëzhgim në 13 gjykata të vendit).

Faqja e Internet-it e TLAS (www.tlas.org.al) është përditësuar rregullisht.

e) QENDRUESHMERIA

Programi i TLAS, i përbërë nga projekte të larmishme në funksion të ofrimit të shërbimeve, të edukimit dhe informimit si edhe të përmirësimit të legjislacionit, është konceptuar dhe zbatuar si një program i qëndrueshëm. Deri tani TLAS është financuar me sukses nga donatorët. Me krijimin e një sistemi shtetëror, institucional të ndihmës juridike, rriten mundësitë e financimit të TLAS por edhe të kapaciteteve të tjera të kualifikuara për shërbim ligjor falas nga vet buxheti i shtetit. Sigurisht TLAS synon dhe pretendon të konkurrojë me shërbime cilësore, me përvojën e pasur 10 vjecare në fushën e trainimeve profesionale si dhe me modelin më efikas në fushën financiare, në atë organizative e menaxheriale.

g) PLANI I AKTIVITETEVE

Gjatë 2008 plani i aktiviteteve u zbatua me përpikmëri sipas projekteve të mëposhtme:

Projekti	Donatori	Shuma:	Kohëzgjatja
Përmirësimi i sistemit të ndihmës ligjore në Shqipëri	Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut	10.920 Euro	01. 05. 2008 – 28. 02. 2009
Përmirësimi i shërbimeve të ndihmës ligjore për pakicat	Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut	61.700 Euro	01. 05. 2008 – 28. 02. 2009
Fuqizimi i pakicave vulnerabel në Shqipëri	UNDP/UNV	74.000 USD	01. 09. 2008 – 31. 12. 2009
Vëzhgim i TLAS për matjen e nivelit të kënaqësisë për përdoruesit e gjykatave	USAID	971, 540 Lekë	15. 05. 2008 – 31. 05. 2008
Projekti Shërbimi Ligjor Falas Tiranë	CAFOD UK	70.000 Euro	01. 01. 2008 – 31. 12. 2008
Fushatë ndërgjegjësimi për ndryshimet e ligjit për regjistrimin e lindjeve.	UNICEF	3345500 Lekë	21. 07. 2008 – 30. 10. 2008
Ofrimi i Shërbimeve Ligjore për Viktimat e tragjedisë së Gërdecit	SOROS	64.444 USD	01. 05. 2008 – 30. 04. 2009
Ofrimi i shërbimeve ligjore për fëmijët, viktima potenciale të trafikimit	Terre des Hommes	10 000 USD	01.09.2007 – 31.10.2008
Fuqizimi i komuniteteve vulnerabel për akses në shërbimet ligjore	UNICEF	40,982 USD	20.11.2008 – 20.04.2009
Përmirësimi i sistemit të ndihmës ligjore, parakusht për rritjen e aksesit në drejtësi	Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës	17,000 USD	10.10.2007 _ 10.11.2008

Disa nga projektet e 2009 jane:

Projekti	Donatori	Shuma:	Kohëzgjatja
Përmirësimi i sistemit të ndihmës ligjore në Shqipëri	Komiteti Suedezi i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut	10.920 Euro	01. 05. 2008 – 28. 02. 2009
Përmirësimi i shërbimeve të ndihmës ligjore për pakicat	Komiteti Suedezi i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut	61.700 Euro	01. 05. 2008 – 28. 02. 2009
Fuqizimi i pakicave vulnerabel në Shqipëri	UNDP/UNV	74.000 USD	01. 09. 2008 – 31. 12. 2009
Projekti Shërbimi Ligjor Falas Tiranë	CAFOD UK	50.000 Euro	01. 01. 2009 – 31. 12. 2009
Ofrimi i Shërbimeve Ligjore për Viktimat e tragjedisë së Gërdecit	SOROS	64.444 USD	01. 05. 2008 – 30. 04. 2009
Fuqizimi i komuniteteve vulnerabel për akses në shërbimet ligjore	UNICEF	40,982 USD	20.11.2008 – 20.04.2009
Vëzhgim i TLAS për matjen e nivelit të kënaqësisë për përdoruesit e gjykatave	USAID/ROLP,	36, 000 USD	2009 – 2010
Përmirësimi i Sistemit të Paraburgimit në Shqipëri	SOROS BUDAPEST	50 000 Euro	2009 - 2010
Përmirësimi i efektivitetit të zbatimit të Ligjit “Për Ndihmën Juridike”	Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (në shqyrtim)	21,000 USD	2009

c) DISA SYNIME:


* Puna e TLAS mbështetet në Planin Strategjik 2007-2010. Me mbylljen e vitit 2008, bazuar në analizat periodike, në bazën e të dhënave të TLAS si dhe në vëzhgimet me grupet e synuara të TLAS përsëri u konkludua të përzgjidhen këto objektiva strategjike:

- 1) Shërbimi ndaj klientëve;
- 2) Ndërgjegjësimi i komunitetit për rritjen e aksesit të tyre në drejtësi;
- 3) Fushata advokimi dhe lobimi për zbatimin e ligjit Për Ndihmën Juridike në Shqipëri, Nisma për përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit dhe politikave sociale;
- 4) Përsosja e punës koordinuese dhe administruese;
- 5) Planifikim më të mirë në fushën e ngritjes së fondeve;

- * Edhe pse TLAS punon bazuar në një numër politikash, rregulloresh dhe strategjish që mbështesin funksionimin e brendshëm të tij, për shkak të miratimit të ligjit “ Për Ndihmën Juridike”, i cili synon të shtrijë këtë lloj shërbimi në të gjithë vendin, është i ndërgjegjshëm që akte të domosdoshme nënligjore dhe dokumente të tjera duhen përpiluar dhe miratuar për të konsoliduar kapacitetet e ofruesve të Ndihmës Juridike. TLAS synon të transferojë përvojën dhe modelin më efikas në ato organizata apo struktura që do të ofrojnë në të ardhmen ndihmën juridike.

Shkurt 2008


Shpërndarja e klientëve sipas vëndbanimit 2005-2008



Në vitin 2008, 62% e rasteve kanë qënë nga klientët që janë banorë të qytetit të Tiranës dhe 29% nga rrethi Tiranë (kryesisht bashkia Kamëz, përfshirë Bathoren, komunat Paskuqan, Zall Herr, Dajt, Vaqarr, etj)


Ne vitin 2008 është rritur pesha e banorëve të qytetit të Tiranës dhe atyre nga rrethet e tjera.

Shpërndarja e klientëve sipas gjinisë 2008




Nga llogaritjet del se numri i klienteve femra që kanë kërkuar shërbim ka qënë më i madh se ai meshkujve. Ndërsa organizatat zenë një numër të vogël.

Shpërndarja e klientëve sipas gjinisë 2005-2008



Si dukuri e përbashkët e të dy viteve, vërehet se predominojnë gratë, me të njëjtën përqindja, afërsisht 68% gra dhe 32% burra

Shpërndarja e klientëve sipas moshës 2005-2008




Predominiojnë klientët e grup moshës 30-40 vjeç, që janë në përgjithësi nga familje me fëmijë të vegjel.

Eshtë jo i vogël edhe numri i klientëve të grupmoshës 18-24 vjeç.


Në vitin 2008 ka rritje të klientëve të të grupmoshës 40-49 vjeç.

Shpërndarja e klientëve sipas gjëndjes civile 2005-2008




Vërehet se në vitin 2008 ka rënie të numrit të familjeve të dala nga zgjidhja e martesës dhe rritje të klientëve të pamartuar.

Shpërndarja e klientëve sipas strukturës 2005-2008



Në vitin 2008 vërehet rritje me 30% e peshës së klientëve nga minoritetet


Burimi i të ardhurave të klientëve 2008



Vërehet se në vitin 2008 është rritur pesha e klientëve të papunë, që punojnë në punë informale dhe që sigurojnë jetesën duke mbledhur mbeturina.


Eshtë shumë e vogël pesha e klientëve që përfitojnë përkrahje sociale nga shteti (më pak se 2% në vitin 2008).

Burimi i të ardhurave të klientëve 2005-2008



Vërehet se në vitin 2008 është rritur pesha e klientëve që punojnë në punë të zezë, që sigurojnë jetesën duke mbledhur mbeturina dhe me aftësi të kufizuar. Eshtë rritur disi pesha e klientëve që përfitojnë përkrahje sociale nga shteti, ndonëse kjo rritje është e pandjeshme.


Kushtet e banimit të klientëve 2005-2008



Predominojnë klientët që banojnë në dhoma teke dhe në barrake, pasuar nga ata që banojnë në banesa të palegalizuara, pra me banim në zonat informale (kryesisht të mbështetur për regjistrim të lindjeve të fëmijëve dhe për transferim të dok. të gjëndjes civile)


Eshtë rritur numri i klientëve me kushte të vështira banimi, që banojnë në barraka.

Prej kujt është mësuar ekzistenca e TLAS 2008



